



MESAZHI I MYFTIUT
ME RASTIN E MUAJIT
RAMAZAN 1439



RAMAZANI MUAJ I AFRIMIT
ME ALLAHUN (XH.SH)



“MËSHIRO
QË TË MËSHIROHESH!”

Viti XVI - Nr. 5 (183),
Maj, 2018

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

NE,
ISLAMI YNË,
KUR'ANI
DHE MUAJI
RAMAZAN...



Vlerat e Medinës së Ndriçuar

“Kushdo që përpiqet t’u ngrejë kurthe banorëve të Medinës,
do të tretet (shkatërrohet), ashtu siç tretet kripa në ujë.”





Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

NE, ISLAMI YNË, KUR'ANI DHE MUAJI RAMAZAN...

Savary në gjuhën frënge të kuptimeve të Kur'anit; është gjëja më e shtrenjtë që posedoj! Gjatë leximit të tij ndjeva kënaqësinë më të madhe dhe u dritësova prej tij, derisa arrita në një gjendje, a thua se rrezet e tij të përjetshme më mbuluan me dritën e tij të begatë!”⁵ – shkrimtari anglez, **W. B. Beckard**.

Të dashur dhe të nderuar,

Pastaj, iu riktheva shënimeve personale të ditarit të datës 13 mars 2017, në Mekë. “Gjatë ditëve të qëndrimit në vendet e shenjta, është e pamundur mos të të bjerë në sy numri i stërmadh i vizitorëve besimtarë nga çdo cep i botës, të cilët në vetvete dhe në natyrshmëri të plotë me kulturat popullore dhe traditat e trashëguara, sjellin me vete edhe

5. El-Husejni El-Husejni Muadi, Ulema ve hukema minel-garb enful-Islam, f. 26.

Po shfletoja lajmet e ditës së sotme, ku ndër të tjera u ndala tek deklarata e zëdhënësit të Presidencës së Turqisë, intelektualit të shquar, Ibrahim Kalin. Sipas TRT në gjuhën shqipe, citohet deklarata kuptimplote e z. Kalin: “Ky është kulmi i injorancës dhe idiotësisë në epokën moderne..!”¹, në lidhje me “kërkesën e intelektualëve francezë për heqjen e disa ajeteve nga Kurani”¹.

Shpejt e shpejt më erdhën ndër mend disa citime objektive të një shumësie dijetarësh, intelektualësh dhe shkencëtarësh të shquar perëndimorë, përfshi edhe francezë, në lidhje me Kur'anin. Fjala bie: “Kur’ani është fjala e All-llahut, e shpallur në gjuhën e pastër arabe, ndërsa përkthimi i tij nuk do ta kalojë nivelin sipërfaqësor. Kush pra, do të mund ta përshkruajë bukurinë e Fjalës së Zotit në çfarëdo gjuhe?”² – profesore e Universitetit të Harvardit, studiuesja gjermane, **Annemarie Schimmel** (1922-2003).

Ose: “U angazhova me studimin e Kur'anit Famëlartë, pa asnjë mendim paraprak rreth tij, me objektivizëm të plotë në kërkim të shkallës së përputhshmërisë së tekstit kur'anor dhe të dhënave të shkencës bashkëkohore. Arrita në përfundimin se, nuk ka asnjë ajet që mund të kritikohet nga pikëpamja shkencore, në kohët moderne”.³ – mjeku i shquar francez, **Maurice Bucaille** (1928-1988).⁴

Ose: “Bleva një kopje të përkthimit

1. <http://www.trt.net.tr/shqip/turqia/2018/05/07/turqia-reagon-ndaj-francesky-eshte-kulmi-i-injorances-dhe-idiotesis-ne-epoken-moderne-965450>

2. El-Husejni El-Husejni Muadi, Ulema ve hukema minel-garb enful-Islam, f. 16.

3. Po aty, f. 18.

4. Pasi u bë musliman, botoi veprën e tij: Teurati, Bibla, Kur’ani dhe shkenca, i përkthyer në 17 gjuhë të huaja.

tiparet e qytetërimeve dhe vendeve, prej nga vijnë.

Sa shkon një grup, ja behin dhjetë të tjerë. Nordikë, amerikanë, italianë, aziatikë, afganë, turqë, shqiptarë, uzbekë, rusë, anglezë.., prej nga s’të zë syri. (Sot pasdite në tavaf, u takova me ca miq të mirë nga Gostivari). Asnjëherë, hapësirat përreth Qabes së Madhnueshme, rrugët e qytetit dhe hotelet e shumta të tij, nuk janë bosh.

Kudo gjen shenja bamirësie, bujari, foto vëllazërore, këmbim adresash, por jo vetëm. Ka edhe studiues, që në këto ditë të begata, këmbajnë mendime e punime, ide dhe alternativa të dobishme, që i shërbejnë projekteve të ndryshme, në dobi të shoqërive, vetë njerëzimit.

E, teksa po përgatitesha të shkruaj

disa nga shënimet e kësaj dite, një mik i shtrenjtë më dërgoi një mesazh, në përbërjen e të cilit, ishte edhe kjo dëshmi, që ia ndryshoi rrjedhën shënimeve të ditës: “Qendra e Shërbëtorit të Dy Haremeve (Mbretit të Saudisë), hapi në Britani, një panair informues rreth Islamit. Në këtë panair mori pjesë edhe një miku ynë, thirrës islam, që tregon sa vijon:

Erdhi një burrë skocez dhe pasi u soll, sa andej-këndej, m’u afrua, më dha selam dhe nisi të fliste me mua. E pyeta nëse kishte dëshirë të dinte diçka rreth Islamit.

“Jo, jo, faleminderit! Nuk më pëlqejnë këto lloj prezantimesh, të cilat jemi mësuar t’i dëgjojmë prej kohësh. Përtej kësaj, kam jetuar në mesin tuaj për shumë vite, në shumë shtete arabe dhe islame. Poashtu, kam lexuar shumë për Islamit dhe di shumë gjëra rreth tij.”,

“U ANGAZHOVA ME STUDIMIN E KUR'ANIT
FAMËLARTË, PA ASNJË MENDIM PARAPRAK RRETH TIJ,
ME OBJEKTIVIZËM TË PLOTË NË KËRKIM TË SHKALLËS
SË PËRPUTHSHMËRISË SË TEKSTIT KUR'ANOR DHE TË
DHËNAVE TË SHKENCËS BASHKËKOHORE.
ARRITA NË PËRFUNDIMIN SE, NUK KA ASNJË AJET
QË MUND TË KRITIKOHET NGA PIKËPAMJA
SHKENCORE, NË KOHËT MODERNE” – Maurice Bucaille

– ma ktheu.

E pyeta: Po çfarë di rreth Islamit?

Tha: “Islami është fé e bukur, e mrekullueshme, disiplinon marrëdhënien tënde me tjetrin, kushdo qoftë ai, musliman a jomusliman. Të mëson si ta adhurosh Zotin tënd, në mënyrë të qartë, si të sillësh me prindër, bashkëshorten, fëmijët, komshiun, mbarë shoqërinë etj.!

Ndërsa ajo, çfarë ju vepron në realitet, është krejt ndryshe. Sepse, ju gënjëni, shani, vidhni, nuk keni respekt për kohën, jeni anarhistë, nuk e doni ligjin, e përçmoni tjetrin, jeni racistë, keni korrupsion, respektoni të pasurin dhe e nënçmoni të varfërin!”

Pastaj, më tha: “Më vjen keq, por më

duket se të vura në siklet!”

Ia ktheva: Ti merr atë që të porositi Libri (Kur’ani) dhe lëre sjelljen e njerëzve!

Ai, luajti kokën në shenjë mohimi, pastaj vijoi: “Ju humbisni paratë dhe kohën tuaj me këto panaire! Ne dijme shumë gjëra për ju. Ndoshta, edhe më shumë nga ç’dini ju për veten tuaj!

Kthehuni nga Libri juaj madhështor, praktikojeni atë që gjeni në të prej sjelljeve dhe parimeve. E, nëse e realizoni si duhet praktikën e tij, do të shihni se si njerëzit do të hyjnë në fenë tuaj, turma-turma, pa pasur nevojë për kësi panairesh. Sepse ne jemi një popull që na intereson rezultati i prekshëm në realitet, më shumë sesa çfarë lexohet në libra!”...

Në fakt, secili prej nesh, e ka për detyrë, të reflektojë dhe të rivlerësojë marrëdhënien e tij me Islamit dhe shoqërinë, familjen, veten, fafësin, kohën, punën, etj. Jo për konstatimet relativisht të sakta të një udhëtari skocez, as për shënimet e mia, as për opinionet e mbarë botës, por për marrëdhënien e tij me Zotin e tij dhe nivelin e sinqeritetit në raport me saktësinë e besimit dhe praktikimit të tij.

E vërteta është se, kjo fé do të mbërrijë, ku ka mbërritur nata dhe dita, kjo nuk ka asnjë dyshim. Ka mbërritur xhanëm! Por, më e rëndësishme se ky fakt hyjnor, që zhvillohet natyrshëm, me a pa ne është se, ku do ta vendosim ne veten tonë; tek muslimanët, në veprat e të cilëve lexohet Islami, apo tek njerëzit e tjerë..?!”¹, mbarojnë shënimet e asaj dite.

Të shtrenjtë,

Ramazani po afron, Kur’ani është aty në duart tuaja, në shtëpitë tuaja, imamët janë përherë pranë jush me mexhliset e përjavshme dhe shërbimet e përditshme! Lutjuni All-llahut t’ju dritësojë mendjen dhe zemrën me Fjalën e Tij dhe lutuni pambarimisht, ashtu si na mëson Resulull-llahu (a.s.), që Zoti i gjithësisë ta bëjë Kur'anin pranverë të zemrës, dritë në gjoks, pastrues të mërziisë, largues i brengave dhe hallevë!

Sikurse lutemi për krejt ata që kanë devijuar në errësirat e injorancës, urrejtjes dhe primitivizmit mesjetar: All-llahu i udhëzoftë nga Drita e Kur'anit!

(Fjala e mbajtur në tribunën fetare të organizuar nga Myftinia Shkodër, në xhaminë “Ebu Bekër”, ditën e hënë, më 7 maj 2018)

MESAZHI I MYFTIUT TË SHKODRËS ME RASTIN E MUAJIT RAMAZAN 1439

**Të dashur dhe të nderuar,
motra dhe vëllezër,
bashkëqytetarë të shtrenjtë!**

Ditën e mërkurë, më 16 maj 2018, rreth dy miliardë njerëz në mbarë botën nisin një marrëdhënie të re me veten, me kohën, me ushqimin dhe pijen, me familjen dhe punën, me Zotin dhe hakun e Tij në jetë! Përse?

Kjo është pyetja që ngacmon herë pas here mendjen dhe zemrën e shumë njerëzve në botë. A ka Zoti nevojë për agjërimin tonë, për adhurimet dhe lutjet, për bamirësitë dhe altruizmin, për pendimin dhe rregullimin e asaj çfarë është prishur në jetën tonë, për zekatin dhe përkrahjen që të pasurit japin për të varfrit, për humanizmin dhe paqen, për të cilat mundohemi dhe përpiqemi çdo ditë drejt lartësisë në gradët më të larta të dëshimit tonë si Njerëz të shtruar e të mbarë, që tokën ndërtojnë me sakrificat e tyre, që ligjet mbrojnë me përkushtimin e tyre, që garanci për tjetrin dhurojnë me besimin dhe dashninë e tyre, që të keqen luftojnë me urtësinë dhe vendosmërinë e tyre, që dorë për dorë me krejt vullnetmirët bashkëpunojnë, për të mirën e familjes së madhe njerëzore dhe forcimin e shtyllave të paqes sociale dhe asaj globale?

A ka Zoti nevojë për krejt këtë dhe përtej kësaj, prej veprave dhe sjelljeve tona, adhurimeve dhe sakrificave të ndryshme? Në fakt, jemi pikërisht ne, ata që kanë nevojë për besimin dhe qetësinë, për paqen dhe sigurinë, për altruizmin dhe bamirësinë, për pendimin dhe kthimin në origjinën e ndërtimit të vlerave, mbështetur mbi pragun e besimit dhe fesë!

Njeriu i sotëm pa moralin e besimit në All-llahun e Plotfuqishëm, Mëshirues, Mëshirëbërës, dështoi në ruajtjen e ekuilibrit të jetës, e vrau vëllanë e tij njeri, i pushtoi tokën, i dogji pasurinë, i shkatërroi trashëgiminë, i mbyti ëndrrat, i hirtësoi qiellin, i nxu jetën, i preu hovin e zhvillimit, përhap drogën dhe alkoolin, imoralitetin dhe devijimet flagrante nga natyrshmëria në të cilën e krijoi Zoti, i kërcënoi paqen dhe sigurinë, stabilitetin dhe pasurinë.., dhe në fund, vazhdoi i qetë rrugën drejt altareve të vetëhyjnizimit, duke harruar se përgjatë

historisë së njerëzimit, krejt idhujt janë shembur, krejt tiranët janë mundur, krejt krimet janë dënuar, krejt devijimet nga natyrshmëria me të cilën Zoti e zbukuroi jetën mbi tokë janë pastruar, ashtu siç Zoti ka urdhëruar!

Atëherë, përse njeriu pa besim e mashtron veten e tij dhe mendon se forca dhe pushteti i përkohshëm, pasuria dhe shoqëria e keqe, humbja e kohës pas epsheve dhe intrigave të shejtanit, përpjekja për të ndërtuar mbi kurriz të hakut të tjetrit, korrupsioni dhe mashtrimi, do ta lartësojnë e do t’i falin lavdi?! Sa gjynah për këtë lloj!

MUAJI I MADHNUESHËM
I RAMAZANIT VJEN PIKËRISHT
PËR QËLLIMIN E LARTË
TË AFRIMIT TONË ME VLERAT
E PËRKUSHTIMIT DHE
PËRSOSJES SË CILËSISË SË
BESIMIT, DUKE NA MBULUAR
ME PELERINËN E MËSHIRËS
HYJNORE, FALJES
DHE GARANTIMIT
TË SHPËRBLIMEVE PA FUND,
NË KËTË JETË
DHE NË TË PËRTEJMEN!

Muaji i Madhnueshëm i Ramazanit vjen pikërisht për qëllimin e lartë të afrimit tonë me vlerat e përkushtimit dhe përsosjes së cilësisë së besimit, duke na mbuluar me pelerinën e mëshirës hyjnore, faljes dhe garantimit të shpërblimeve pa fund, në këtë jetë dhe në të përtejmen!

Hapjani dyert e zemrave All-llahut, përgjigjuni ftesës së Tij, dëshmojeni veten muslimanë të përkushtuar, që asgjë nuk kanë mbi besimin dhe Zotin, prej ku marrin forcë dhe energji pozitive për të dashur e vështuar me sytë e mëshirës dhe paqes çdo gjë; tokën, atdheun, njeriun, krejt krijesat, vetë jetën!

All-llahu ju dashtë e ju bekoftë!

Me zemër të mirë Ramazanin 1439!

Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, më 15 maj 2018



Durim Kasemi,
imam, xhamia Parrucë

Përpara se të hymë në muajin e agjërimit, është e rëndësishme të jemi të vetëdijshëm dhe të ndërgjegjshëm plotësisht, se sa shumë ndikojnë gjynahet në pengimin e të shijuarit të agjërimit dhe të çdo adhurimi në përgjithësi. Gjynahet qëndrojnë pas ftohtësisë që mund të ndjejë njeriu në ramazan. Nëse në ramazan ndjehesh sikur je në një muaj, ditë apo kohë të zakonshme, atëherë dije se gjynahet të kanë penguar ta ndjesh mirësinë dhe bereqetin e këtij muaji dhe kësaj kohe të mrekullueshme.

Përfitimi moral, shpirtëror dhe besimor nga Ramazani është synim i gjithsecilit, e me këtë motiv duhet të hyjë në ramazan por, jo të gjithë dalin prej ramazanit me këtë përfitim. Nga ramazani askush nuk mund të dalë barazim – as i humbur dhe as i fituar – por ka vetëm dy mundësi, ose i humbur dhe, ose i fituar. Sepse Pejgamberi (a.s) ka thënë: “U largoftë nga mëshirë e Allahut, ai i cili e arrin Ramazanin dhe nuk i falen gjynahet”¹. Pra, ose të falen gjynahet, ose nuk përfiton këtë falje për shumë arsye, që kanë të bëjnë me vetë njeriun dhe asgjë tjetër, dhe përfshihesh nga mallkimi i Xhebrilit dhe Pejgamberit (a.s).

Nëse hyn në Ramazan sikur nuk po ndodh asgjë, dije se zemra e shpirti jot janë mbuluar nga gjynahet dhe ato të pengojnë ta shikosh me sytë e zemrës e të shpirtit, dritën që rrezaton ky muaj. Gjynahet të pengojnë të shijosh shijen e veçantë që ka ky muaj dhe të kënaqesh me të, ashtu sikur kënaqesh me shijen e një ushqimi të shijshëm, edhe pse ndryshimi është tepër i madhe, sepse e para është shije shpirtërore kurse e dyta materiale.

Dije se formula sekrete e përjetimit të vërtetë të Ramazanit është në dorën tënde dhe të askujt tjetër. Ti je ai që

AGJËRIMI DHE GJYNAHET

vendos se, a do ta përjetosh dhe shijosh Ramazanin apo jo. Dhe ky vendim ka të bëjë me gjynahet, pendimin prej tyre dhe heqjen dorë menjëherë nga ato. Disa njerëz vendosin të largohen nga gjynahet vetëm gjatë Ramazanit me njet që pasi të mbarojë Ramazani, do të vazhdojnë përsëri avazin e tyre të gjynaheve.

Kjo nuk është gjë tjetër vetëm se mashtrim i vetvetes dhe se Ramazani i këtij njeriu është vetëm privim i vetës nga ushqimi e pija dhe asgjë më shumë. Kjo nuk do të thotë që ky njeri të mos agjërojë por, të përmirësojë njetin dhe të ndërgjegjësohet për dëmet e gjynaheve dhe ndikimin e tyre në përjetimin e adhurimeve.

Për të kuptuar më mirë se si dhe sa ndikojnë gjynahet në agjërimin tonë dhe në shijimin e tij do të ndalemi shkurtime në tre tekste kuranore dhe profetike, ku secili përshkruan një aspekt të dëmit dhe përcjellë tek ne mesazhe mjaft domethënëse.

Pejgamberi (a.s) thotë²: “Kur njeriu bën një gjynah, në zemrën e tij vendoset një pikë e zezë, e nëse ai pendohet dhe kërkon falje ajo pastrohet, e nëse ai kthehet dhe vepron përsëri, pikat e zeza shtohen e shtohen përsëri derisa, zemrën e tij ta mbulojë e zeza. Atëherë ky person është nga ata që ka përmendur Allahu në Kur’an ku thotë: “Veprat e tyre (të këqija) i kanë ndryshkur zemrat e tyre (i kanë nxirë e i kanë mbuluar).” - (Mutaffin: 14)

Por, çfarë është nxirja e zemrës dhe ç’ndikim ka në jetën shpirtërore dhe besimore të njeriut dhe si ndikon ajo në shijimin dhe përjetimin e adhurimit. Për ta kuptuar më qartë këtë duhet të lexojmë me vëmendje këtë hadith madhështor, në të cilin Pejgamberi (a.s) tregon se kur zemra nxihet nga fitnet e gjynahet, çfarë i ndodhë asaj. Ai (a.s) thotë: “...lloji tjetër i zemrës është ajo e zeza dhe kjo është sikur gota e përmbysur, e që nuk njih të mirën dhe as nuk privohet nga e keqja, por vetëm pason egon dhe epshin e saj.”³

Kuptimi i i këtij hadithi është, siç e përcjellë edhe imam Neveviu se, njeriu kur pason egon, nefsin dhe epshin e vet, e bie në gjynahe, në zemrën e tij futet çdo gjynah dhe bashkë me të edhe errësi dhe zymtësi, e kur zemra të jetë e tillë,

drita e besimit largohet prej saj, sikurse edhe nga gota e përmbysur largohet çdo pikë uji që ka brenda dhe nuk mbetet gjë në të⁴.

Në suren Ali Imran, ajeti 155 Allahu thotë: “Ata, nga mesi i juaj që u zmrapsën në ditën kur u ndeshën të dy ushtritë, në të vërtetë, shejtani i shtyu në gabim, për shkak të disa gjynaheve që kishin bërë. E, Allahu, ua fali (gabimin), sepse Ai është Falës dhe i Butë”.

Ky ajet tregon për atë që i ndodhi muslimanëve në betejën e Uhudit nga largimi i shigjetarëve nga kodra e tyre dhe tregon se përse ky grup besimtarësh ranë në gjynahun e moszbatimit të urdhrat të Pejgamberit (a.s). Ata ishin sahabë të Pejgamberit, kishin shkuar në betejë me të, që tregon se nuk ishin njerëz të rëndomtë për nga imani por, këtu del në pah një e vërtetë shumë e rëndësishme për secilin prej nesh.

Gjynahet edhe pse mund të jenë pak e të vogla dhe të papërfillshme në syrin e njeriut, i hapin rrugë shejtanit dhe i lehtësojnë atij humbjen dhe devijimin e njeriut. Ashtu sikur arriti ti largonte sahabët e Pejgamberit nga zbatimi i urdhrat të tij, ashtu arrijnë, madje me më shumë lehtësi për shkak të gjynaheve të shumta që kemi, të na bëjë të biem në gjynahe e të mos e ndjejmë ëmbëlsinë dhe shijen e Ramazanit e të mos përfitojmë prej tij.

Dijetari i shquar Ibn Sirin, në një periudhë të jetës së tij sprovohet me borxhe të shumta dhe kjo i solli brengosje të madhe. Pas kësaj ai tha: E di shkakun e kësaj mërzie e brengosjeje dhe të kësaj fatkeqësie, ai është një gjynah që e kam bërë që para dyzet viteve. Kur kjo i shkoi në vesh Ebu Sulejman Ed-Darani, ai tha: Ata kanë bërë aq pak gjynahe sa që e kanë ditur se nga u ka ardhur e keqja, por unë dhe ju që na janë shtuar gjynahet e nuk e dimë se nga do na vijë e keqja. Vaj halli për ne!⁵

Nëse Ibn Sirinit e keqja dhe sherri i gjynahut i kishin sjellë borxhe e halle, ne duhet të kujdesemi në këtë prag Ramazani të mos na godas e keqja e gjynaheve tona në agjërimin tonë për shkak të gjynaheve të shumta e të mos e shijojmë atë. Nuk po them gjynahet që i kemi bërë më herët, por gjynahet në këto

ditë në prag të Ramazanit.

Humbësi i Ramazanit është humbësi i vërtetë. Ai që nuk merr asgjë nga Ramazani, nuk merr shtimin e besimit, nuk merr kënaqësitë e adhurimit, nuk merr përsosmërinë shpirtërore që të jep ky muaj, ai duhet ngushëlluar, e duhet vajtuar sepse ka humbur jetën e vërtetë, atë të shpirtit.

Një ditë Pejgamberi (a.s) doli në xhami me qëllim që t’i tregonte sahabëve se kur dhe cila ishte Nata e Kadrit e ta përcaktonte atë, por në atë moment po debatonin dhe po bënëin shamatë dy persona, Pejgamberi (a.s) tha: “Dola me qëllim që të tregoj se kur dhe cila është Nata e Kadrit, por filani dhe filani, dy prej jush, bënë shamatë dhe ajo, përcaktimi i Natës së Kadrit, mu hoq nga mendja, dhe shpresoj të jetë hajr për ju. Kërkojeni atë në natën e njëzet e një, njëzet e tre dhe njëzet e pesë, ose në natën e njëzet e pesë, njëzet e shtatë dhe njëzet e nëntë.”⁶

Të ndalemi pak tek ky hadith dhe të shikojmë se si, ky veprim i vogël në dukje, debati dhe shamata në xhaminë e Pejgamberit, që është vend adhurimi dhe jo vend fjalësh boshe dhe debati e grindjeje, është bërë shkak që muslimanët e asaj kohe të privoheshin nga përcaktimi i Natës së Kadrit.

Shikoni se si gjynahu fshiu bereqetin e Ramazanit, sepse kjo gjë ndodhi në Ramazan. Shikoni se si gjynahu pengoi përhapjen e mëshirës, jo vetëm tek individit por edhe tek bashkësia në mesin e të cilës ndodhi ai gjynah.

A thua vallë gjynahet që ne bëjmë çdo ditë e çdo natë, në prag të Ramazanit dhe jo vetëm, na pengojnë të shijojmë dhe të përjetojmë ëmbëlsinë dhe shijen e këtij adhurimi?! Pa as më të voglin dyshim që po!

Suffjan Eth-Thevriu për këtë thotë: Një gjynah që kam bërë, është bërë shkak që të mos mund të fal namaz nate për pesë muaj. E pyetën se çfarë ishte ai gjynah? Ai tha: Një ditë pashë një njeri duke qarë, siç duket ishte në namaz a lutje, dhe thashë me vete, kjo është sa për sy e faqe!⁷

Së fundmi, vëllezër dhe motra, të largohemi nga gjynahet në këtë prag Ramzani dhe të vendosim sinqerisht të pendohemi tek Allahu dhe të jemi të sinqertë në atë çfarë kërkojmë prej Ramazanit. Të përmirësojmë njetin, të forcojmë bindjen dhe vullnetin për të dalë nga Ramazani me gjynahe të falura dhe me sevape të mëdha.

6. Transmetuar nga Muslimi.
7. Ihja Ulumid-Din, 2/200.

PËRSE RAMAZANI SHNDËRROHET NË MUAJ ZBAVITJEJE, NË VEND TË NJË MUAJI SHPIRTËROR?

Nuk jam hoxhë dhe as thirrës, por tani e kuptoj, se përse nëna ime gjatë gjithë muajit të Ramazanit e kthente televizorin me fytyrë nga muri.

Isha fëmijë i vogël dhe mërziatesha me nënën time, e cila më ndalonte mua dhe vëllezërit e mi të për të parë serialet humoristike.

Kaluan vite e jeta më mori në vrullin e saj, ndërkohë betejat e studimeve dhe punës më kishin mbuluar me heshtjen e tyre pyetjen e fëmijërisë. Derisa, Allahu deshi të më sjellë përgjigjen e kësaj pyetjeje nga një njeri i moshuar, jo i arsimuar, në cepin tjetër të rruzullit tokësor. Ky njeri ishte një punëtor amerikan në stacionin e karburantit, në të cilin e kisha bërë zakon të hyja për të blerë kafe, ndërkohë që furnizojë makinën me karburant kur shkoja në punë.

Një ditë përpara krishtlindjeve hyra për të blerë kafënë si zakonisht, ndërkohë që gjej këtë njeri të preokupuar në vendosjen e drynave frigoriferit të pijeve alkoolike. Kur u ktheje te kasa për të bërë llogarinë e kafesë sime e pyeta, meqenëse unë nuk isha i njohur me ligjet amerikane:

Përse i vure dry këtij frigoriferi?

M’u përgjigj: Ky është frigoriferi i pijeve alkoolike dhe ligjet e Shteteve të Bashkuara e ndalojnë shitjen e pijeve alkoolike në natën e krishtlindjeve, ditën e lindjes së Krishtit.

E pashë i çuditur dhe i thashë: A nuk është Amerika shtet laik? Përse shteti

ndërhyn në një diçka të tillë?

Njeriu më tha: Respekti! Duhet që të gjithë të respektojnë lindjen e Krishtit dhe të mos pinë alkool në këtë ditë, madje edhe nëse nuk janë fetarë. Nëse shoqëria humb respektin, atëherë kemi humbur çdo gjë!”

Respekti.. “Respekt”, kjo fjalë më mbeti në mendje duke m’u vërtitur më ditë të tëra, pas asaj nate. Alkooli nuk është i ndaluar (haram) te shumë të krishterë në Amerikë, por çështja nuk është tek hallalli dhe harami... Ajo është çështje respekti. Ata e shohin krishtlindjen si mysafir, që i viziton çdo vit për t’u kujtuar atyre lindjen e Krishtit (a.s), kështu që nuk është prej respektit të dehurit në prani të këtij mysafiri!

Shpresoj ta respektoj më muajin e Kur’anit dhe të dimë se çfarë të shikojmë, sepse kush lë diçka për hir të Allahut, Allahu do t’ia zëvendësojë me diçka më të mirë, se sa ajo që ka lënë “Kush i madhëron dispozitat e Allahut, atëherë kjo është prej devotshmërisë së zemrave”.

Ne jemi të bindur se media jonë sot e ka hequr fjalën respekt nga fjalori i saj, por a do të stolisësh ti me një çikë respekt dhe ta rrotullosh ekranin e televizorit?!

Dr. Mustafa Mahmud,
nga artikulli: “Përse media arabe nuk e respekton Ramazanin”

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja





Hasan Baftijari
teolog, Shkup

omer ibnul Hatab (r.a): “E kur fillova ta dëgjoj Kur’anin, thashë: ‘Sa fjalë e bukur dhe bujare qenka kjo’. Zemra m’u zbut e sytë më rridhnin rrëke. Kjo edhe më shtyu ta pranoj Islamin”.

All-llahu nuk i ka krijuar njerëzit shkel e shko, e as që i ka lënë mbi tokë të pa udhëzuar. I mençur është ai, i cili e kupton urtësinë e ekzistencës së vet, e vazhdon dhe zhvillon jetën me mendjehollësi, e lë këtë botë pas vete pa u nënshtruar e përbuzur.

Qysh herët në histori, njerëzit i kanë munduar këto pyetje: Nga kemi ardhur? Si jetojmë? Ku do të shkojmë? Kur’ani është zëri i të vërtetës më të cilin janë ndërtuar toka e qiejt. Kuptimet e tij janë rreze, në të cilat reflektohen kuptimet e Shpalljes së lartë hyjnore. Më këtë Shpallje u ballafaquan të parët dhe të fundit. Përmes këtyre kuptimeve, të gjithë ata që deshën të dinë të vërtetën, arritën të kuptojnë se prej nga erdhën, si jetojnë dhe ku do të shkojnë. Kur’ani është Libri gjithëpërfshirës i legjislacionit më të madh Hyjnor, për zbatuesin e të cilit Zbritësi i tij ka garantuar lumturi në të dyja jetët, ndërsa atij që i kthen shpinën i është kërcënuar me mjerim në të dyja botët.

Ai është Libri i vetëm për të cilin All-llahu ka garantuar paprekshmërinë, ruajtjen nga të shtuarit apo të pakësuarit prej tij, ndryshimin apo shtrembërimin e tij dhe mbetjen e tij në tokë deri sa ta ngrejë atë në fund të jetës së kësaj bote. Kur’ani, mrekullia e përhershme e Zotit të Plotfuqishëm, i ka zbritur Pejgamberit të nderuar të Islamit në periudha dhe kohëra të ndryshme, sipas nevojës së njerëzimit. Ajetet e Kur’anit, ashtu siç tërhiqnin zemrat drejt vetes, e pastrojnë pluhurin e paditurisë (inJORANCËS) dhe i njihnin njerëzit me mëshirën dhe të mirën. Shumica dëshirojnë të njihen me shkaqet e shpalljes së ajeteve kur’anore

KUR’ANI BURIM I UDHËZIMIT

dhe të informohen me ngjarjet, të cilat u bënë shkak i shpalljes se ajeteve në sfera të ndryshme.

Kur’ani Famëlartë përmban shkenca të ndryshme brenda tij, megjithëse njeriu, të cilit ai iu shpall, nuk dinte shkrim e lexim dhe as që kishte shkuar ndonjëherë te ndonjë mësues apo në shkollë për të mësuar. Në Kur’an gjejmë shkencat: Astronomi, Mjekësi, Histori, Gjeografi, Legjislacion dhe Drejtësi, Politikë dhe Strategji luftarake etj. Përmbajtja e Kur’anit e këtyre shkencave të ndryshme është argument i fortë se ai është Fjalë e All-llahut të Lartësuar dhe shpallje nga Ai, pasi që është absurde që të gjitha këto shkenca të burojnë nga një njeri i pashkolluar, i cili nuk di shkrim e këndim. Sikur që edhe Kur’ani ka sfiduar oratorët dhe gjuhëtarët arab për të përpiluar dhjetë sure sikur ai, apo madje të një sureje të vetme, ata nuk arritën ta bënin një gjë të tillë. Ky ishte argumenti më i madh dhe prova më e fortë se Kur’ani është Fjalë e All-llahut dhe në asnjë mënyrë nuk është fjalë e njeriut.

Sot mediat në botë, me propagandat e tyre të shumta, përpiqen të prishin pamjen e Islamit dhe ta paraqesin Kur’anin si një libër të vjetër. Qarqe të ndryshme, duke përdorur mjetet më moderne, përpiqen të dobësojnë muslimanët dhe të ulin ndikimin dhe përhapjen e Islamit në botë. Në këtë mes ne shikojmë se Kur’ani Famëlartë, duke qenë si një dritë e madhe e Zotit të Vetëm, në mënyrë shumë të qartë paraqet të vërtetën e tij.

Kur’ani tërheq pas vetes mendjet dhe kjo është vetëm një nga veçoritë e tij. Kur’ani është një udhëzues që të fton për tek e vërtetë, një Libër lutje e përmendje të shpeshta të Krijuesit, emrit të Zotit. Ai ka karakter konstruktiv, sepse ndikon mbi botën e ndjenjave të njeriut. Kur’ani ndërron dhe rregullon vlerësimin e gabuar të njerëzimit të zhytur në errësirën e mohimit dhe herezisë mbi gjithësinë, jetën dhe njeriun, duke realizuar kështu transformimin më të madh. Kur’ani i magjepsi arabët që nga çasti i parë, pa marrë parasysh a ishin prej atyre që All-llahu ua zgjeroi gjokset për Islamin, apo ata në zemrat e të cilëve vuri perde.

Nëse e lëmë anash grupin e vogël në fillim të paraqitjes së kësaj feje, te të cilët shkak i besimit të tyre ishte

vetë personaliteti i Muhammedit (a.s), si bashkëshortja e tij Hadixheja, shoku i tij Ebu Bekri, djali i axhës Aliu, shërbëtori i tij Zejdi e të ngjashmit me ta, do të shohim se Kur’ani është faktori vendimtar, ose njëri prej faktorëve vendimtarë për pranimin e besimit të atyre që besuan në ditët e para të da’ves (thirrjes islame), atëherë kur Muhammedi (a.s) nuk kishte krah as pozitë, kurse Islami nuk kishte pushtet e as aleatë.

Disa vite më parë, në Toronto tregohej historia e një njeriu, i cili punonte në

KUR’ANI TËRHEQ
PAS VETES MENDJET
DHE KJO ËSHTË VETËM
NJË NGA VEÇORITË E TIJ.
KUR’ANI ËSHTË NJË UDHËZUES
QË TË FTON PËR TEK E
VËRTETË, NJË LIBËR LUTJE E
PËRMENDJE
TË SHPESHTA TË KRIJUESIT,
EMRIT TË ZOTIT.
AI KA KARAKTER KONSTRUKTIV,
SEPSE NDIKON MBI BOTËN
E NDJENJAVE TË NJERIUT.

marinën tregtare për të siguruar jetesën. Një musliman i dha atij një kopje të përkthimit të Kur’anit për ta lexuar. Ky njeri nuk dinte asgjë për Islamin, megjithatë ishte shumë i interesuar në leximin e Kur’anit. Kur e mbaroi se lexuari, ia ktheu librin muslimanit dhe e pyeti: “A ishte Muhammedi detar?” Ai kishte ngelur i mahnitur nga mënyra se si Kur’ani përshkruante një shtrëngatë në mes të detit. Kur atij iu tha “Jo, në fakt Muhammedi ka jetuar vetëm në shkretëtirë”, kjo ishte më se e mjaftueshme për të. Ai e pranoi Islamin menjëherë. Ky njeri ishte mahnitur me përshkrimin e shtrëngatës në Kur’an, sepse vetë e kishte provuar një diçka të tillë. Ai e dinte se përshkrimi “... një dallgë, mbi të një tjetër dallgë dhe mbi të retë në qiell.” (Kur’an, En-Nur: 40) nuk mund të vijë nga një person që vetëm do të kishte imagjinuar stuhinë në det; kjo patjetër ishte shkruar nga dikush që e dinte se çdo të thotë një stuhinë në det. Ky

është vetëm një shembull, i cili tregon atë, se Kur’ani në fakt nuk është i lidhur me një vend apo kohë të caktuar.

Pa dyshim, idetë shkencore të shprehura në të, gjithashtu, nuk e kanë origjinën nga shkretëtirat e 14 shekujve më parë. Kur’ani nuk është quajtur i mrekulli vetëm nga myslimanët, të cilët e vlerësojnë, e besojnë dhe janë të kënaqur me të, por ai është quajtur i habitshëm edhe nga jomuslimanët. Çudia më e madhe për ata jomuslimanë, të cilët e kanë parë Kur’anin me një sy kritik, ka qenë se Kur’ani nuk ka qenë kurrë ashtu sikurse ata kanë menduar. Ata mendojnë se Kur’ani është një libër i vjetër, i cili e ka origjinën rreth 14 shekuj më parë nga shkretëtirat arabe; kështu ata presin që libri të ketë një pamje të tillë, një libër i vjetër nga shkretëtirat. Më vonë zbulojnë që libri nuk i ngjan aspak asaj, që ata kishin pritur. Për më tepër, nga mendimet e para që kanë disa njerëz, është se, përderisa ai është një libër i vjetër që vjen nga shkretëtira, ai duhet të flasë vetëm për shkretëtirat.

Në fakt, është e vërtetë që Kur’ani flet edhe për shkretëtirat, imagjinata e tij përshkruan edhe shkretëtirat, por ai gjithashtu flet edhe për detin - apo ç’do të thotë të jesh në një shtrëngatë në mes të detit. Hulumtuesi anglez Kenet Grejki, metodën e lehtë të kuptuarit të ajeteve të Kur’anit e cilëson si shkakun kryesor të depërtimit të tij në zemra dhe thotë: “Në qoftë se Pejgamberi i Islamit do të ishte një filozof sikur Hegeli dhe për përhapjen e Fesë Islame, në vend te rregullave të thjeshta dhe të buta, të parashtronte në Kur’an teori filozofike si ato të Hegelit, do të ishte e pamundur që Islami në botën e para 14 shekujve të krijojë rrënjë dhe të përhapet kaq shumë nëpër botë”.

Por, ja, natyra butë e Kur’anit bën që edhe Velid bin Mugire, kundërshtar i Muhammedit (a.s) dhe i Kur’anit, të detyrohet ta shfaqë dashurinë e tij ose besnikërinë, ku thotë: “Pasha All-llahun, fjala e tij ka ëmbëlsi, në të qëndron një mrekulli, s’ka bukuri mbi të, afër tij çdo fjalë shkrihet, andaj edhe s’ka fjalë më të lartë dhe asgjë nuk mund t’ia kalojë”. Ky Kur’an përshkruan përshtypjen që e lë në shpirtat e atyre që i besojnë dhe në shpirtat e atyre që u erdhi dituria më parë (Libri i shenjtë) dhe se atyre: “Prej (dëgjimit të) tij rrëqethen lëkurët e atyre që i kanë dronë Zotit të tyre, e pastaj me përkujtim të All-llahut u qetësohen lëkurët dhe zemrat e tyre.” (Zumer: 23) “Kur u lexohet atyre, ata hedhen me fytyra (për dhë) duke i bërë



sexhde. Dhe thonë: ‘I lartësuar qoftë Zoti ynë, premtimi i Zotit tonë është i realizuar’. Dhe duke qarë bien me fytyra (kur dëgjojnë Kur’anin) dhe ai ua shton edhe më tepër përuljen (ndaj All-llahut).” (Isra: 107-109)

Ky Kur’an i siguroi rizgjimit islam elemente të ekzistencës dhe kompletimit, në atë mënyrë që nuk do arrinin ta formonin njëmijë ministri të propagandës nëse do të rreshtoheshin për të ushqyer ndjenjat e emocionet dhe mendimet me mijëra filma dhe oratorë vigjilentë të rangut të lartë. Ky Kur’an ishte për lëvizjen islame gazetë, radio, libër dhe oratori e saj. Nga ajetet e tij u lëkundën e u dridhen breza e breza të stagnuar, më ndihmën e tij i thyen prangat e injorancës së parë dhe ndërtuan një rizgjim të ri, i cili u karakterizua më të vërtetë e veta. Ky rizgjim nuk u nis dhe nuk u ngrit vetëm nga një njeri, në mënyrë që të vdesë bashkë me të, por buroi nga thellësitë e shpirtave, të cilët besuan fuqimisht dhe me bindje.

Kur’ani arriti të ketë këtë ndikim tek miqtë dhe armiqtë përmes sekreteve e mrekullive, të cilat i prezantuan dijetarët nga Libri i Zotit dhe sekreteve të amshueshmërisë, të cilën ia dha Zoti ajeteve të tij. Admiruesit e mrekullive materiale nuk i pëlqenin këto konsekuenca të ndikimit të tij. Ata thonin duke shpresuar: “Sikur të ishte ndonjë Kur’an që me të do të ecnin malet, që më të do të plasej toka, që më të do të flisnin të vdekurit.” (Er-Rra’d: 31) Por, JO u themi atyre. Më këtë Kur’an ecin burrat (njerëzit), më të rregullohet toka, më të flasin të gjallët.

Ky Libër riformon jetën në modele të reja; shpirtave ua kthen shikimin e shëndoshë; njerëzit i mbron nga e keqja e djajve, ndyrësitë e të marrëve dhe

traditat e injorantëve dhe mohuesve. Ky është Libri i ekzistencës, atë e njeh kush një vetveten dhe kush di qëllimin e jetës së vet që nga fillimi e deri në mbarim, përderisa mohuesit do ta kuptojnë të vërtetën nëse nuk e kuptojnë sot: “... Jo, (ata nuk besojnë) se e tërë çështja i takon vetëm All-llahut. A nuk e kanë të qartë ata që besuan se, sikur të donte All-llahu do t’i drejtonte në rrugë të drejtë të gjithë njerëzit; por ata që nuk besuan, e për shkak të asaj që bënë, do t’i godasë vazhdimisht fatkeqësi e kohës ose do ta rrethojë (fatkeqësia) vendin e tyre deri sa të vijë urdhri i All-llahut. All-llahu nuk e thyen premtimin.” (Er-Rra’d: 31) Kur’ani është burim i dritës, mëshirës dhe behar i zemrave.

Kjo mrekulli e madhe e Profetit është fjala e shpalljes Hyjnore e cila me ligjet humane dhe të plota e çon njeriun drejt së vërtetës. Kur’ani është i ngjashëm me drurin Tuba (një dru në Xhennet), i cili origjinën dhe rrënjët i ka në xhenet, ndërsa degët i ka të lëshuara në gjithësi.

Pra, njeriu i cili arrin të kapet në një rrënjë prej degëve të këtij druri, vetë do të bëhet një lulishte me dritë dhe gëzim, si dhe në trupin e tij mëshira dhe dashuria do të lëshojnë rrënjë. Ajetet e Kur’anit janë degët e drurit Tuba, kurse një nga këto degë thotë: “Me njerëzit flisni me të mirë”. Kur’ani është si një lum që rrjedh nëpër kohë dhe çdokush që e shfrytëzon atë fiton jetë dhe lumturi. Ky lexohet Kur’ani, nga qielli bie shiu i mëshirës dhe bereqeti Hyjnor mbi shpirtin e njeriut. Leximi i Kur’anit duhet të jete me ide dhe logjikë, sepse Kur’ani është recitali më i bukur i jetës dhe përjetësisë. Sado që të përparojë dija dhe shkenca e njerëzimit, njeriut i paraqiten pamje dhe recitale të reja nga ky dokument qiellor. Secili në Kur’an do të gjejë aq sa vlen ai në të vërtetë.

KUJTIME RAMAZANI

KUJTIME RAMAZANI 1

Kur isha fëmi, gjyshi e gjyshja (paçin rahmet) më mbanin në prehër. Më tregonin histori e përralla nga ma të ndryshmet. S'pari, ata dy më banë me dashtë Zotin. Ata më mësuani me qenë musliman. Në prag Ramazan e intensifikonin punën përgatitore që un e dy motrat e mia ma të mëdha të agjionim. Kam shumë kujtime nga ajo kohë. Herë-herë më mbushen sytë me lot e mallëngjehem për ta. Hala e kam në hundë erën e trupave të gjyshit e gjyshes. Gjyshes i vinte era ujë e gjyshit edhe pak erë duhani.

Gjyshja më tregonte përralla me Fatimen e Isufin. Tash s'din kush ma aso përrallash. Ndërsa gjyshi më tregonte histori të vjetra, shumë të vjetra. Kur donte të më thonte se burri duhet të jetë i mençur më fliste për Nastradinin e kur donte të mbrunte trimërinë në mua më fliste për Saladinin. Ma për zemër kishte Saladinin gjyshi. Nuk e kam kuptuar deri vonë pse. Në prag Ramazan, para se flej i këndoj edhe të largëtve ndonji sure. Edhe Saladinin. Se pse në lidhje me Saladinin kam mbetur akoma fëmijë. Akoma besoj se një Saladin do shfaqet një ditë, të paktën sa për të më hequr mallin për gjyshin. Apo ndoshta për të ma ngopë dëshirën!

Ramazani po vjen... bi me fjetë e zani i gjyshes më l'mon veshët e shpirtit. Më porositi të agjinoj e të jap sadaka sa të mundem.

- Xhabiri i nans e din ti vetë...

- Zejnep shpirt, mos ki dert se po. Qofsh në dorë të Allahut!

KUJTIME RAMAZANI 2

Nuk e kujtoj sa kam qenë në moshë, por i vogël, diku tetë e nëntë vjeç. Ishte viti i parë për ne dhe po na mësonte gjyshja me agjinu. Ju agjionim me copa na thoshte e un ua qepi copat e ua baj ditë. Me copa do të thonte me agjinu tri ditë rresht nga një gjysë dite e të katërtën ditë të plotë. Kështu deri në gjysë të Ramazanit, si dhe Naten e Kadrit të plotë. Kur agjionim ditët e plota kishim detyrë me fjetë dy orë mbasdite. Me fjet n'zheg i thonë shkodranët. Ndër ditët gjysma, do hanim drekë, por shumë pak dhe do pinim ujë mbas dreke, por vetëm një gotë ndarë në tre seanca. Kur nuk agjionim fare (dy javët e dyta të Ramazanit) ishim të detyruar me u zgju në syfy si dhe me hangër iftarin me agjinuesit. Dy motrat e mia ndihmonin gjyshen me gatimet e un

bëja blerjen e ushqimeve. Mbasditeve delnim në çardak e gjyshi na vinte të lexonim mevludin e Hafiz Ali Korçës.

E kam akoma parasyshtë atë libër të shtypur e lidhur me aq kujdes. Faqet ishin të ndara në dy pjesë vertikale dhe fletet pak të ashpra si fletët e fletores së vizatimit e bënin librin edhe më të pëlqyeshëm. Myzejeni, motra ime e madhe lexonte ma së shumti. Ajo kishte



talent në interpretim e kësaj ishte e preferuara e gjyshit. Kur pat dalë axha nga burgu, edhe ai vitin e parë bëri si ne fëmijët. Agjionte me copa e gjyshja ia qepte. Axha kishte dalë i sëmurë nga burgu, kishte tuberkuloz. Gjyshja e donte shumë axhen. I dhimbsej se kishte kaluar të shumtën burgjeve e mbet pa krijuar familje. Nganjherë e kapja me sytë me lot.

Pjesa ma e bukur e Ramazanit ishte kur mblidheshin të gjithë tek ne për taravi. Ishte ajo ndjenja e solidarizimit, e kryerjes së veprimit ilegal dhe përmbushja e detyrës ndaj Zotit. Kajherë vinin vetëm pleq, miq e kushrinj të gjyshit me tespi në xhepat e xhaketa të vjetra. Ata faleshin në rresht e un vetëm imitoja lëvizjet si pozicionoheshin një hap mbas tyre. Ishte vjeshtë e un vilja rrush e fiq për mysafirët nga pemët e oborrit.

Shpërblimin për hyzmetin që u bëja pleqve do e vilja për Bajram. Të gjithë ma falnin nga një pesëdhjetëshe.

KUJTIME RAMAZANI 3

Ishte fillim Shtatori por vapa e verës s'dinte të largohej. Nganjherë të shtunave, baba më merrte me vete në punë. Shkoja me dëshirë ndonëse nuk kishte farë variacioni a kënaqësie tjetër

të çuditshëm. "Ndërmarrja Rruga-Ura". E caktonin me punë përherë jashtë qytetit e kështu nganjherë mungonte natën në shtëpi. Flinte te barakat e gjeologëve a te kapanonet e minatorëve. Se ç'ishte një minierë diku nga malsia në një katund me emër skiç, Kurtaj. Bakër më duket se nxirrnin apo kërkonin.

Atë ditë që po shkoja me babën ishte me punë në segmentin Va i Dejes - Qafë Çelë. Një ditë ma parë më kishte thanë me ble buk gruni sa të mundja. Thua edhe ndoj shoku bab, më thoshte se sevap ban. Janë do miq të mi në katund fukara të shkundur që agjinojnë e u vjen mirë kur u çoj buk gruni se e kan ma lehtë e u shijon ma shumë iftari e syfyri. Pata ble tri. I futëm në një trastë pece e un i mbaja hedhur pas shpine. Në Va të Dejës zbritëm nga autobuzi e hipëm në karrocërinë e një kamioni. Shoferi e dinte ku me zbritë secilin. - Gani ulu ti e Lutfiu thirri ai nga kabina si e uli pak shpejtësinë. - Jo jo i tha baba, kam djalin sot për ndihmë. Jepja Lutin dikuj tjetër.

Tek ecnim ngadalë drejt grumbujve të çakullit baba më tha se për Lutfiun flitej të ishte hafije. Rruga ishte e shkretë. Ndoshta një kamion në orë kalonte aty pari. Gjinkallat plasnin kangën monotone të zhegut. Mbasi mbushnim ca gropa të rrugës me çakull, hidhnim trastat e veglat (në lopatë e në kazëm) mbi shpinë e merrnim rrugen përpjetë. Ja te ata shtëpijat atje do i çojmë bukët më tha baba duke shtrirë dorën në drejtim të tri a katër shtëpijave të vetmuara bri rrugë. Asht një plak bab, nja shtatëdhjetë a tetëdhjetë vjeç, i sëmurë me veshka e mëlçi që agjionon me buzët e plasura. I ka dalë edhe diabet e ai vazhdon me agjinuë përkundër këshillës së mjekut e të një gjysë hoxhe që e ka fis. Ati i çoj përditë nga një buk kur më caktojnë këndej. I ndrit fytyra plakut kur më sheh me trastë shpinës. Rrugës për tek shpija e Kasemit, ndalëm disa herë për të plotësuar gropat me çakull. Kur mbërritëm te shtëpia e parë doli një burrë plak e na ftoi me u futë nën hije të hardhisë. U ulëm mbi do trupa të prerë pemësh që shtriheshin përdhe. Mbasi morëm pak veten nga vapa e madhe bëmë këmbë. Mos shkonin sot nga Kasemi tha ai. - Pse? Pse çka ka ndodhë, e pyeti baba me habi. Dje ka qenë shumë keq dhe e kan çuar në spitalin e Pukës na tha.

Baba ishte i heshtur e i përmbajtur nga natyra. Nuk foli fare. Veç uli kryet.

Kur dolëm nga oborri në rrugë morëm teposhten drejt Shkodrës. Nuk folëm...

Kasemi kishte ndërruar jetë agjinueshëm më tha baba dy ditë ma vonë kur u kthye nga puna. Kasemin e kishin përcjellë te vorret vetëm një grusht njerëz

të afërm. Askush nuk u shkon kulakëve as në dasma as në mort tha, sikur po fliste me veten. Nana ndali ujë e çesmes e me pjatë plot shkumë ne dore erdh ngadalë drejt babës. Ky ishte një ndër ata rastet që shihja nga nana i sigurtë që do ishte me sy të lagur.

KUJTIME RAMAZANI 4

Vinte tek ne herët në mëngjes diku nga ora shtatë a tetë. Fuste dy duart njëherësh në xhepat e barnavekëve nën bohçen e gjatë deri në fund të kambëve duke pa përreth sikur po shpërndante trakte. I jepte gjyshes time do kokrra vezë, një a dy domate e kush di çka tjetër.

Gjyshja ia merrte e i thoshte lehtë sa me zor me e ndi: Zoti ta baftë kabull!

Një ditë, dy e tri e gjyshi që e kish pa skenën e pyet gjyshen: -Zejnep, Zoten m'thuj të drejten pse vjen Haxhirja përditë kohët e fundit me do kokrra vezë e domate e çikrrime tjera? - Kot more kot.

-Jo moj jo kot. S'ka luft mendsh Haxhirja ishalla me ardh kot te na përditë, por fol tash.

-Kot, kot. Nuk a pun për ty.

-Zejnep t'kam zanë be Zotin, fol tash!

-Lene plak, ik se a pun grashë.

-Mir, mir po e la.

Vjen Ramazani e Haxhirja te na për iftar. Bajmë iftar, pijnë nga një kafe mbrapa e mandej Haxhirja niset.

-Natën e mirë e kabull ishalla!

-Naten e mirë Haxhire e hajde prap nesër n'iftar e!

Një natë, një tjetër e një tjetër e Haxhirja si një natë për natë vinte te na për iftar.

Un nuk i thoja gjyshit pse. E kisha pa Haxhiren e shkretë tu q ka i tregonte gjyshes se si Hakiu, i biri që ishte komunist e sekretar partie diku ku banin shporta e kishte ba me prishë agjionim një ditë sa ishte kthi prej punet. Tash ajo ikte para iftarit sa pa ardh Hakiu në shpi që mos me e detyru i biri me hangër. Hakiu e kishte ftyren krejt bira t'vrame lije e të kuqe si all. Flokët e rrallë i sillte përreth tullës si petull. E kishte shumë Zoti vetë. Prej njëqind metrash larg ja shifje ftyren si të thut.

E pata pyet një herë ma vonë gjyshin pse nuk i fliste Hakiut kur shiheshin përballë. Ktheu kryet nga un, më ra shpatullave e më ngjeshi për shtat. Të rujt Allahu Xhabo, më tha. E dija përgjigjen në të vërtetë. Edhe gjyshi e pa se e dija. Qysh atë ditë me gjyshin merreshim vesh me kode. Shihnim njëri-tjetrin në sy, buzën në gaz lehtë... e kaq.

Xhabir Tabaku



Pejgamberi (a.s) ka thënë:

"Kur vjen

Ramazani

hapen dyert

e xhennetit,

mbyllen dyert

e xhehenemit

dhe prangosen

shejtanët."

(Transmetuar nga Muslimi)

VLERAT E MEDINËS SË NDRIÇUAR

Transmetohet nga Ebi Hurejre (r.a) se i Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë:

“Jam urdhëruar të emigroj në një qytet që i dominon qytetet, i thonë “Jethrib” dhe kjo është Medina; ai qytet i largon njerëzit (e këqinj) ashtu siç i largon zjarri papastërtitë e hekurit.” – (Buhariu)

Transmetohet nga Aisha (r.a) se i Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë:

“Kushdo që përpiket t’u ngrejë kurthe banorëve të Medinës, do të tretet (shkatërrohet), ashtu siç tretet kripa në ujë.”

Medina e Ndriçuar ishte qyteti i zgjedhur nga Allahu për të qenë vendi ku do të emigronte dhe shtëpia ku do të gjente paqe Profeti i Tij i nderuar, paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të! Allahu i madhërishtëm me mëshirën e Tij të paanë, bëri që ky qytet të bëhej i dashur për Profetin e Tij dhe gjithë ata që e ndiqnin dhe e mbështesnin.

Kur njerëzit e Mekës po thurnin plane kundër të Dërguarit të Allahut, paqja qoftë mbi të, që ta vrisnin, ta burgosnin ose ta dëbonin nga vendi, Allahu i Madhërishtëm bëri planet e Veta. Ai i Madhërishtëm e urdhëroi të Dërguarin e Tij që të emigronte në Medine dhe e mësoi të bënte këtë lutje:

“O Zoti im, më shpjer në një hyrje të kënaqshme, më nxirr me një dalje të kënaqshme dhe më dhuro nga Ti fuqi, që do të më ndihmojë!” – (Kur’ani, El-Isra: 80)

Dhe vërtetë, Allahu i Madhërishtëm bëri që Profeti (a.s) të dilte nga Meka pa e prekur asnjë e keqe, dhe në Medinen e Ndriçuar gjeti mikpritje, nderim e mbështetje.

EMRAT E KËTJ QYTETI TË BEKUAR

Është Medina

Transmetohet nga Ebi Hurejre (r.a) se i Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: “Jam urdhëruar të emigroj në një qytet që i përpin qytetet, i thonë Jethrib dhe kjo është Medina; ai qytet i largon njerëzit (e këqij) ashtu siç i largon zjarri papastërtitë e hekurit.”- (Buhariu)

Taiba dhe Taba

Për pastërtinë dhe jetesën e mirë të njerëzve aty, Medina është quajtur edhe Taiba dhe Taba, emra që përmbajnë kuptimin si “gjë e mirë”.

Abu Humaid Es-Saidiu, Allahu qoftë i kënaqur me të, tregon për një rast kur po ktheheshin nga Beteja e Tebukut bashkë me të Dërguarin e Allahut, paqja qoftë mbi të, kur kishin mbërritur në Luginën El-Veda’, i Dërguari i Allahut kishte thënë: “Unë do të shpejtoj. Kush të dëshirojë le

të shpejtojë me mua, e kush dëshiron, le të qëndrojë.”

Ebu Humaidi tregon: Ne vazhduam me të, derisa në horizont u duk Medina dhe Profeti (a.s) tha: Kjo është Taba (për Medinën) dhe ky është Uhudi, një mal që na do dhe e duam.” – (Buhariu dhe Muslimi)

Medina njihet edhe me shumë emra të tjerë si: **Toka e Allahut, Toka e Hixhretit** (emigrimit), **Përpirësia e qyteteve, Vendi i shenjtë i të Dërguarit të Allahut, Qyteti i besimit, Qyteti i paqes, Qyteti i traditës profetike, Vendi i palmave, Tiba, Kryeqyteti, Qyteti i Profetit, Qyteti i ndritur, Qyteti i nderuar**, etj.

Medina e Ndritur, ky qytet i Shenjtë, ka shumë virtyte dhe veçori, saqë dijetarët i kanë numëruar rreth njëqind të tilla, por këtu do të përmendim vetëm disa prej tyre.

MEDINA E NDRIÇUAR ËSHTË QYTET I SHENJTË ASHTU SI MEKA

Profeti Muhammed (a.s) e nderoi atë qytet me ardhjen e tij. Ai (a.s) iu lut Allahut që ta bekonte e ta shenjtëronte Medinën ashtu si Mekën, madje edhe një herë më shumë.

Transmetohet nga Abdullah ibni Zejd Mezinu (r.a), se i Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: “Ibrahimi e shenjtëroi Mekën dhe u lut për banorët e saj. Edhe unë e kam shenjtëruar Medinën ashtu siç e ka shenjtëruar Ibrahimi Mekën dhe gjithashtu edhe unë jam lutur që Allahu t’i bekojë (në atë që përmbajnë) enët e tyre (me të cilat matin ushqimin) dyfish sa është lutur Ibrahimi për banorët e Mekës.” – (Buhariu dhe Muslimi)

Si përgjigje ndaj lutjes së Profetit Muhammed (a.s), Allahu i Madhërishtëm e ka bërë Medinën e Ndritur një vend të shenjtë e të sigurt. Aty nuk lejohet që të sulmohet, madje as të trembet ndokush.

Sehl ibn Hanif (r.a) ka thënë: I Dërguari i Allahut (a.s) bëri me dorën e tij për nga Medina dhe tha: “Ky është një vend i shenjtë, i sigurt.” – (Muslimi)

Allahu i Madhërishtëm e zgjodhi këtë

vend të ishte qyteti ku do të emigronte Profeti i Tij (a.s)

Nga Xherir ibn Abdullah (r.a) është transmetuar se Profeti (a.s) ka thënë: Allahu i Plotfuqishëm më ka frymëzuar se: “Në secilin prej këtyre tre vendeve të shkosh, do të jenë vend i mirë për ty, për të emigruar: Medina, Bahrejni ose Kansrini (në Siri).” – (Tirmidhiu)

Dijetarët thonë se më pas i ishte përcaktuar Medina, prandaj i urdhëroi shokët e tij që të emigronin atje.

BESIMI ZË VEND NË MEDINE

Medina e Nderuar është djepi i Islamit. Nga nderimi që Allahu i Madhërishtëm i ka bërë këtij qyteti të pastër, është se ashtu si Allahu bëri që aty të përhapet besimi dhe nga aty besimi të përhapet në çdo cep të tokës, ai përsëri kthehet në këtë qytet dhe mblidhet aty. Sa herë që besimi dobësohet në shpirtrat e njerëzve, kthehet aty që të ripërtërihet.

Ebu Hurejra (r.a) ka treguar se i Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: “Besimi shkon e vjen në Medine ashtu siç shkon e vjen gjarpri në vrimë e tij.” – (Buhariu dhe Muslimi)

Përsa i përket besimit, i Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: “Besimi ndodh të vjetërsohet në shpirtin e ndonjërit prej jush, ashtu siç vjetërsohet rroba, prandaj kërkoni nga Allahu të jua ripërtërijë besimin në zemrat tuaja!” – (Hakimi, Taberaniu, etj)

MEDINA ËSHTË E RRETHUAR ME MELEKË QË E RUAJNË ATË

Allahu i Madhërishtëm e ka mbrojtur këtë qytet duke vënë në çdo qoshe të tij engjëj që e ruajnë.

Ebu Hurejre (r.a) transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: “Në çdo portë apo cep të Medinës ka melekë. Në të nuk hyn murtaja (sëmundje) as dextrali mashtrues.” – (Buhariu dhe Muslimi)

Transmetohet nga Enesi (r.a), se Profeti (a.s) ka thënë: “Medinën do ta mësyjë dextrali mashtrues që të hyjë në të, por do të ndeshë në melekët që e ruajnë, prandaj aty nuk mund të

hyjnë dextrali as murtaja, me vullnetin e Allahut.” – (Buhariu)

SHUMËFISHIMI I SHPËRBLIMIT TË NAMAZIT NË XHAMINË E PROFETIT

Xhabir ibn Abdullah (r.a) tregon se i Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: “Namazi në këtë xhaminë time është më i mirë se një mijë namaze diku tjetër, përveç xhamisë së Shenjtë (Qabes); dhe xhumaja në këtë xhaminë time është më e mirë se një mijë xhuma diku tjetër, përveç në

qëndrojtë të vdesë në Medine, le ta bëjë, sepse unë ndërmjetësoj për atë që vdes aty.” – (Ahmedi dhe Tirmidhiu)

Xhamia e Profetit është njëra nga tri xhamitë, të cilat këshillohet të vizitohen për shpërblimin e madh që ka udhëtimi drejt tyre

Është transmetuar nga Ebu Hurejre (r.a), se Profeti (a.s) ka thënë: “Udhëtimi për adhurm ndërmërret vetëm drejt tri xhamive: Xhamia ime, xhamia e Shenjtë (Qabja) dhe xhamia Aksa.” – (Buhariu

“Nëse Allahu i Madhërishtëm e vendos për ndonjë rob të Tij të vdesë në një vend të caktuar, Ai krijon për të një nevojë në atë vend.” (Tirmidhiu, Ahmedi dhe të tjerë)

Aisheja (r.a) ka thënë se kur po diskutonin se ku ta varrosnin të Dërguarin e Allahut (a.s), Ebu Bekri (r.a) tha: “E kam dëgjuar Profetin (a.s) të thotë: Profeti ndërron jetë në vendin më të dashur për të.” Pastaj Ebu Bekri (r.a) tha: Varroseni aty ku ishte kur ndërroi jetë!”

Ndërsa sipas transmetimit të



xhaminë e Shenjtë (Qabe); dhe muaji i Ramazanit në këtë xhaminë time është më i mirë se njëmijë muaj Ramazani diku tjetër, përveç në xhamisë e Shenjtë (Qabe).” – (Bejhakui)

PROFETI (A.S) E KA NXITUR QËNDRIMIN NË MEDINE

Sufian ibn Ebi Zuhejr (r.a) ka thënë: E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (a.s) të thotë: “Do të çlirohet Jemeni dhe do të vijnë njerëz që bëjnë gati gjithë ç’kanë e shkojnë atje me gjithë familjet e tyre edhe me ata që i ndjekin, ndërsa Medina është më e mirë për ta, po ta dinin. Pastaj çlirohet Shami (Levanti) dhe do të vijnë njerëz që bëjnë gati gjithë ç’kanë e shkojnë atje me gjithë familjet e tyre edhe me ata që i ndjekin, ndërsa Medina është më e mirë për ta, po ta dinin. Pastaj çlirohet Iraku dhe do të vijnë njerëz që bëjnë gati gjithë ç’kanë e shkojnë atje me gjithë familjet e tyre edhe me ata që i ndjekin, ndërsa Medina është më e mirë për ta, po ta dinin.” – (Buhariu dhe Muslimi)

PROFETI (A.S) E KA NXITUR QËNDRIMIN NË MEDINE DHE VDEKJEN NË TË

Ibn Omeri (r.a) tregon se i Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: “Kush mund të

dhe Muslimi)

Në një transmetim prej tij nga Muslimi (r.a), thuhet se i Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: “Udhëtohet (për adhurm) vetëm për në tre xhami: Xhamia e Qabes, xhamia ime dhe xhamia e Ilias (Aksa në Kuds)”

NË XHAMINË E PROFETIT GJENDET NJË PJESË TOKE, VEND I XHENETIT

Nuk dimë të thuhet për ndonjë vend nga toka të jetë gjithashtu pjesë e xhenetit, përveç këtij vendi të nderuar, që është mes minberit dhe shtëpisë së të Dërguarit të Allahut (a.s)! Kjo është një veçori e shtuar në vargun e të mirave të këtij ymeti, me të cilat Allahu i Madhërishtëm na ka nderuar ne si ymet mysliman.

Transmetohet nga Abdullah ibn Zejd El-Ensari (r.a), se i Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: “(Vendi) Mes këtyre shtëpive - do të thotë shtëpia e tij – deri tek mimberi im, është një kopsht nga kopshtet e xhenetit, dhe minberi im gjendet mbi një lumë nga lumenjtë e xhenetit.” – (Ahmedi)

MEDINA ËSHTË VENDI KU ËSHTË I VARROSURI DËRGUARI I ALLAHUT (A.S)

Transmetohet nga Matar ibn Ukamis (r.a) se i Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë:

Tirmidhiut, Ebu Bekri (r.a) ka thënë: “Kam dëgjuar nga i Dërguari i Allahut (a.s) diçka që nuk e kam harruar: Allahu i Madhërishtëm çdo Profet e merr aty në vendin ku atij i pëlqen të varroset.” Pastaj Ebu Bekri tha: “Prandaj varroseni aty ku ka ndërruar jetë, aty ku është shtrati i tij!”

Ebu Davudi transmeton nga Ebu Hurejre (r.a), se i Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: “Sa herë që dikush më dërgon mua selam, Allahu ma kthen shpirtin që edhe unë t’ia kthej përgjigjen atij”.

“Allahumme sal-li ala Muhammedin ve ala ali Muhammed, kema sal-lejte ala Ibrahim ve ala ali Ibrahim, inneke Hamidun Mexhid.

Allahumme barik ala Muhammedin ve ala ali Muhammed kema barekte ala Ibrahim ve ala ali Ibrahim inneke Hamidun Mexhid.”

O Allah, derdh mëshirën Tënde mbi Muhammedin dhe familjen e tij, ashtu siç mëshirove Ibrahimin dhe familjen e tij! Vërtet Ti je i Lavdishëm dhe i Madhëruar.

O Allah, begatoje Muhammedin dhe familjen e tij, ashtu siç begatove Ibrahimin dhe familjen e tij! Vërtet Ti je i Lavdishëm dhe i Madhëruar.

Përgatiti:
Msc. Arta Ujkaj, teologe



Idmir Plaku,
imam, xhamia "Ebu Bekër"

Ramazani vjen tek ne si një mundësi afrimiteti tek Allahu (xh.sh), afrimiteti në mëshirën e Tij, afrimiteti në dashurinë e Tij, afrimiteti në shpërblimin e veçantë e pa masë të Tij, e kjo falë obligimit të agjërimit, i cili e bën besimtarin të jetë përherë në gjendje falënderimi dhe ibadeti. Në këtë kontekst Allahu (xh.sh) thotë: “(Të xhenetit janë) Edhe ata që pendohen, ata që sinqerisht adhurojnë, ata që falënderojnë (Allahun), ata aqë gjërojnë, ata që bëjnë ruku, që bëjnë sexhde, që urdhërojnë për të mira e ndalojnë nga të këqijat, edhe ata që përmbushin dispozitat e Allahut. Pra, përgëzoji besimtarët...”¹

Muslimanët e përjetojnë Ramazanin duke agjëruar, sipas dispozitave të Islamit. Këto dispozita të jetës së besimtarit i japin një dimension tjetër, të ndryshëm nga ai rutinës së përditshme. Sepse sjellja e tij ndryshon, i privon vetes ushqimin, pijen e pasionet e epshit që në njëmbëdhjetë muajt e tjerë të vitit i ka të lejuara. Kjo disiplinë, korrektësi e qëndrueshmëri që buron nga besimi e bën të dashur e të afruar tek Allahu (xh.sh). Siç Pejgamberi (a.s) ka thënë në hadithin kuds: “Agjërimi është i Imi dhe Unë shpërblej për të.”²

Allahu (xh.sh) e veçoi agjërimin në shpërblim sepse muslimani nuk mund t'i afrohet askujt në adhurim me uri dhe etje përveç Allahut, kjo edhe për sinqeritetin në fshehtësi ndryshe nga ibadetet e tjera. Transmetohet nga Abdullah ibn Eufa se Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Gjumi i agjëruarit është ibadet dhe frymëmarrja e tij është tesbih.”³

Agjëruesi e ruan gjendjen e afrimitetit me Allahun për aq kohë sa fjalori i tij nuk ka gibet, thashetheme, edhe nëse ai ndodhet në gjumë. Muaji i Ramazanit

1. Et-Teube: 122.
2. Transmetuar nga Buhariu.
3. Transmetuar nga Bejhekiu.

RAMAZANI MUAJ I AFRIMIT ME ALLAHUN (XH.SH)

na fton në shoqërinë e ibadetit, qoftë në namaz, agjërim, lexim Kur'an, dhënie sadakaje e çdo vepër tjetër e mirë. Të gjitha këto ibadete e bëjnë besimtarin të afruar dhe të dashur për Allahun. Kur robi arrin një pozitë të tillë, gjynahet i janë falur, lutja i është pranuar dhe kënaqësia e Allahut për të është e aprovuar. Këta besimtarë i gjejnë të përshkruar në Kur'an dhe gëzojnë këto cilësi. Allahu (xh.sh) thotë: “Nuk ka dyshim se për muslimanët e muslimanet, besimtarët e besimtare, adhuresit e adhureset, të sinqertit e të sinqertat, durimtarët e durimtare, të përlulurit e të përlulur, sadakadhënësit dhe agjëruarit, ruajtësit e nderit dhe ruajtëset e nderit, shumëpërmendësit e Allahut e shumëpërmendëset e Allahut, Allahu ka përgatitur falje dhe shpërblim të madh.”⁴

Të gjitha këto cilësi që Allahu (xh.sh) ia vë në dukje muslimanit kanë fituar kënaqësinë e Tij në sajë të nijetit të sinqertë. Këto cilësi Allahu (xh.sh) i përshkruan si besim, ibadet, virtyte morali, ndjesi shpirtërore që nuk mund t'i posedojë askush, veçse ai që e ndjen afërsinë e Allahut në kryerjen e obligimeve ndaj Tij. Allahu (xh.sh) në Kur'an e ka bashkërenduar në shumë ajete kuranore namazin me zekatin, ndërsa Pejgamberi (a.s) në hadithet që kanë lidhje me muajin e Ramazanit e ka bashkërenduar namazin me agjërimin duke nanxitur, inkurajuar dhe përgëzuar se veçanërisht këto ibadete na bëjnë të jemi afër mëshirës së Allahut. Në këtë kontekst Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Allahu ka bërë obligim për ju agjërimin e Ramazanit dhe kam bërë synet faljen e namazit të natës. Ai që e agjëron dhe e fal namazin me besim në obligueshmërinë e tij dhe duke shpresuar shpërblimin, për këtë do të dalë i pastër prej mëkateve si ditën që e ka lindur nëna.”⁵

Gjithashtu Allahu (xh.sh) na ka treguar se besimtar i gjen ndihmën, kurajon për ecur me dinjitet në jetën e kësaj bote duke qenë praktikues i këtyre obligimeve. Për këtë ka thënë: “O ju që keni besuar kërkonin ndihmë me durim e me namaz, se vërtetë Allahu është me durimtarët.”⁶ Ashtu si në namaz dhe në agjërim zemra e besimtarit përjeton miraxhin e pastërtisë

4. El-Ahzab: 35.
5. Transmetuar nga Amedi.
6. El-Bekare: 156.

së saj. Miraxhi i pastërtisë së saj është dëshmi, që në namaz vendi më afër Allahut është sexhdeja, e për agjëruarin koha e iftarit, është gëzimi i jetës. E në kohën e iftarit dua e agjëruarit është e pranuar se Allahu është afër nesh me diturinë, rahmetin, mbikëqyrjen, përcaktimin dhe pranimin e Tij. “E kur robërit e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër...”⁷

Allahu (xh.sh) në Kur'an thotë: “Të pyesin Ty (O Muhamed)” e përmend në disa ajete kuranore, e më pas e urdhëron që t'u përgjigjet pyetjeve sipas zbritjes së shpalljes. Si p.sh :Allahu (xh.sh) thotë: “Të pyesin ty (Muhamed) për plakën (e fituar në luftë), thuaju: “Plaçka është çështje që i takon Allahut dhe të Dërguarit...”⁸

Ndërsa kur u bë një pyetje e tillë se a është afër apo larg?! Allahu e dha përgjigjen vetë duke thënë: “Unë jam afër...” për atë që më përgjigjet me ibadet duke besuar në obligueshmërinë e tyre. Madje shumë afër siç thotë Allahu (xh.sh): “Ne jemi më afër tij se damari i qafës.”⁹

Pikërisht në këtë muaj qarkullimi i gjakut në këtë damar duhet të jetë nën kontrollin e agjërimit. Mendo, arsyeto pak rreth kësaj përgjigje të drejtpërdrejtë, të prerë me një fjali të thjeshtë (në aspektin gjuhës) kuptimplotë e të butë në aspektin hyjnor, që sheh e dëgjon lujtjet tona fshehtas e haptazi.

Medito pak në hadithin kuds që Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Allahu (xh.sh) ka thënë: “Unë jam me mendimin e robit tim për Mua. Unë jam me të kur më kujton dhe nëse më kujton në vete edhe Unë e kujtoj atë në atë mënyrë. Nëse më përmend në grup edhe Unë do ta kujtoj atë para një grupi edhe më të mirë. Nëse më afrohet një pëllëmbë, Unë do t'i afrohem atij një kut. Nëse më afrohet një kut, Unë do t'i afrohem atij një pash. Nëse më vjen duke ecur, Unë do t'i shkoj atij duke vrapuar.”¹⁰

Padyshim që të qenurit i lidhur me këtë muaj nëpërmjet ibadetit është pjesë e etikës së besimtarit. Kushtoni kujdes edukatës dhe fjalorit tuaj, sepse nga ajo e largon agjëruarin nga vlera e agjërimit dhe e bën këtë muaj si gjithë muajt e tjerë. Në këtë muaj kushtoni rëndësi

7. El-Bekare: 186.
8. El-Enfal: 1.
9. Kaf: 16.
10. Transmetuar nga Buhariu.



Naim Drijaj,
imam, xhamia Parrucë

Çfarë na kujton muaji i i begatë i Ramazanit?

1. Muaji i Ramazanit na kujton rëndësinë e besimit.

Allahu (xh.sh) thotë: “O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.”¹ Ibn Mes'udi (r.a) ka thënë: “Nëse gjeni në Kur'an thirrjen “O ju që besuat ose O ju njerëz” kini vëmendjen sepse çështja që vjen pas kësaj thirrje i përket një rëndësie shumë të veçantë”. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Islami është ndërtuar mbi pesë shtylla, njëra ndër to është agjërimi i Ramazanit.”² Një ndër qëllimet e agjërimit është edhe arritja e devotshmërisë.

ÇFARË ËSHTË DEVOTSHMËRIA?

Omer ibn Abdulazizi ka thënë: “Devotshmëria është të lësh atë që ka ndaluar Allahu dhe të bësh atë që të ka urdhëruar Ai”.

2. Muaji i Ramazanit na kujton begatinë e madhe që na ka dhënë Zoti (xh.sh) Kur'anin famëlartë.

Allahu i Lartësuar thotë: “Muaji i Ramazanit është ai në të cilin ka zbritur Kur'an, që është udhëzues për njerëzit dhe dallues i së mirës nga e keqja.”³ Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Agjërimi dhe Kur'an do ndërmjetësojnë për njeriun ditën e Kijametit, Agjërimi thotë: “O Zot! Ka braktisur ushqimin dhe epshin për mua. Pranoje ndërmjetësimin tim”.

1. El-Bekare: 183.
2. Transmetuar nga Buhariu, Muslimi, Tirmidhiu.
3. El-Bekare: 185.

ruajtjes së lidhjes farefisnore dhe atyre shoqërore.

Transmetohet se Ibën Mes'udi (r.a) kaloi pranë një grupi njerëzish, të cilët kishin dalë në rrugë. U afua pranë tyre e u tha: Shokët e Pejgamberit i kanë bërë vizitë njëri-tjetrit për hirë të Allahut. Ata

ÇFARË NA KUJTON MUAJI I RAMAZANIT?

Kur'an thotë: “O Zot! Ka lënë për mua gjumin e natës. Pranoje ndërmjetësimin tim”. Agjërimin dhe Kur'anin u pranohet ndërmjetësimi.”⁴

Leximi i shumtë i Kur'anit, duke bërë edhe hatme (leximi i plotë i Kur'anit): i Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të) e lexonte të gjithë Kur'anin në Ramazan bashkë me Xhibrilin (a.s). Në vitin e fundit të jetës, ai e ka lexuar Kur'anin dy herë bashkë me Xhibrilin (a.s).⁵

3. Muaji i Ramazanit na kujton ndalimin nga fjalët e kota dhe veprimet e pahijshme.

Ebu Hurejrah (r.a) tregon, se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Agjërimi nuk është frenimi nga ngrënia dhe pija, por agjërimi është frenimi nga fjalët e ndyra dhe të këqija. Nëse dikush të shan, ose sillet vrazhdë me ty, thuaji: “Unë jam agjërueshëm, unë jam agjërueshëm.”⁶ Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Kush nuk e lë gënjeshtren dhe punën me të, Allahu nuk ka nevojë që ai ta mbajë barkun bosh.”⁷

4. Muaji i Ramazanit na kujton mirësinë e madhe të falënderimit dhe të përkujtimit të mirësive të Allahut.

Besimtari duhet të përkujtojë mirësitë, begatitë e Allahut dhe ta falënderojë Atë për të mirat që i ka dhënë dhe të jetë bujar. Aishja (r.anha) tregon, se i Dërguari i Allahut ishte shumë bujar dhe i përkushtuar në adhurime, sidomos gjatë muajit të Ramazanit.”⁸

5. Muaji i Ramazanit na kujton faljen e namazit të teravive me xhemat.

Profeti (a.s) ka thënë: “Kush e fal (namazin e teravisë) me imam derisa ta përfundojë (atë), i shkruhet sikur të jetë falur tërë natën.”⁹ Pejgamberi (a.s)

4. Transmetuar nga Ahmedi, Taberani në Kebir dhe Hakimi.
5. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.
6. Transmetuar nga Ibn Khuzejmeh, Ibn Hibani, Hakimi. Dhehebiu e vlerëson hadithin të saktë, sipas kushteve të Muslimit.
7. Transmetuar nga Buhariu, Ebu Dvudi dhe Tirmidhiu.
8. Transmetuar nga Buhariu.
9. Transmetuar nga Tirmidhiu nr. 806, Ebu Davudi nr.1375, Nesaiu nr.1605, Ibn Maxheh nr. 1327.

ka thënë: “Kush falet gjatë (netëve të) Ramazanit, me besim dhe shpresë që do shpërblehet, atij i falen të gjitha gjynahet që i ka bërë më parë.”¹⁰

6. Muaji i Ramazanit na kujton mirësinë e madhe të lehtësimit.

Allahu i Lartësuar thotë: “Allahu dëshiron që t'ju lehtësojë (agjërimin) dhe jo t'jua vështirësojë”.¹¹ Njëmbëdhjetë muaj ankohe mi se nuk kemi punë ndërsa kur vjen muaji i Ramazanit themi: “Nuk mund të agjëroj se kam shumë punë.”

Ibn Abbasi (r.a) duke shpjeguar ajetin kuranor: “Ata që kanë vështirësi për të agjëruar, duhet të ushqejnë si shpagim nga një të varfër për çdo ditë agjërimi”.¹² thotë: “Kush nuk ka mundësi të agjërojë, apo kur agjëron e ka tepër të vështirë ta mbajë atë, ha por duhet të ushqejë një të varfër për çdo ditë si shpagim. Persona të tillë janë: shtatzëna, gjdhënësja, i moshuari dhe ai që ka sëmundje të përhershme”.¹³ Gruja, nëse është shtatzënë ose gjdhënëse dhe frikohet se mos e dëmtojë veten ose fëmijën e saj me agjërim, atëherë asaj i lejohet të mos agjërojë. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Allahu, udhëtarit ia ka hequr nga detyrimi, gjysmën e namazit dhe agjërimin, kurse shtatzënës dhe gjdhënëses agjërimin.”¹⁴

7. Muaji i Ramazanit na kujton rëndësinë e lutjes.

Allahu (xh.sh) në fundin e ajeteve të agjërimit thotë: “Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, Unë jam pranë, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua.”¹⁵ Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Tre personave nuk u refuzohet lutja: agjëruarit deri kur të bëjë iftar, udhëheqësit të drejtë dhe njeriut të cilit i është bërë padrejtësi.”¹⁶

10. Transmetuar nga Muslimi nr.759
11. El-Bekare: 185.
12. El-Bekare: 184.
13. Taberiu në Tefsir 2/79 nr.2752-2753
14. Tirmidhiu nr.715, Nesaiu 3/301, Ibn Maxheh nr.1667.
15. El-Bekare: 186.
16. Tirmidhiu nr.2526, Ahmedi 2/305.

E lusim Allahun që të jemi prej atyre që i përfshin mëshira e Tij dhe ditët e Ramazanit na i begaton me vepra të mira. I përgëzoj ata besimtarë që e përjetojnë këtë muaj me ibadet dhe ndjej keqardhje dhe lutem për ata që e anashkalojnë, Allahu i udhëzoftë, i faltë dhe i mëshiroftë.



Arben Halluni, teolog

Çdo njeri besimtar që mbushet me mëshirë të vërtetë tregon natyrshmërinë e tij, dëlirësinë e shpirtit dhe pastërtinë e zemrës së tij. Pejgamberi ynë (a.s) ka qenë model në të gjitha çështjet e kësaj jetë material, duke përfshirë këtu edhe mëshirën e tij të gjithanshme, të cilën e shfaqti në çdo hap të jetës, para dhe pas misionit profetik. Në Kur'anin Famëllartë thuhet: “Juve ju erdhi i dërguari nga lloji juaj, atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndjeshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët” - (Et-Teube: 128)

E kundërta e mëshirës është ashpërsia dhe egërsia me njerëzit dhe me çdo gjallesë tjetër. I Dërguari i Allahut ka thënë në një hadith të tij: “Nga njerëzit që janë larg mëshirës së Allahut është ai që e ka zemrën e ashpër (jo të mëshirshme).

Islami na ka urdhëruar që mëshira të jetë e përgjithshme dhe jo e kufizuar. Ne duhet të jemi të mëshirshëm dhe të paqtë me të gjitha njerëzit dhe krijesat në përgjithësi pa marrë parasysh besimin, racën, kombësinë, ngjyrën, gjuhën etj. Edhe në qoftë dikush ndaj nesh nuk është i mëshirshëm ne jemi të urdhëruar nga Allahu (xh.sh) dhe të shprehim mëshirën tonë universale me botën njerëzore, shtazore dhe bimore.

Përveç saj, duhet të kuptohet se çështja e mëshirës është një det i thellë në mendjen dhe shpirtin e çdo njeriu besimtar. Qenien tonë të mëshirshëm duhet kuptuar si virtyt, i cili duhet të na shoqërojë gjatë tërë jetës për të ndryshuar vetveten dhe shoqërinë. Nuk është vetëm durimi ajo që i dha forcë Pejgamberit (a.s), në rrugën e thirrjes, por edhe mëshira që tregoi me njerëzit gjatë misionit të tij të shenjtë. Rasti i Taifit, Profeti (a.s) u mohua dhe u ofendua, bile u lëndua ashpër. Në atë

“MËSHIRO QË TË MËSHIROHESH!”

gjendje të rëndë fizike dhe shpirtërore i erdhi meleku Xhebrail si krah dhe ndihmë për mundësinë e shkatërrimit të atij populli. Por Pejgamberi (a.s), i dërguar si mëshirë për botët, nuk deshi shkatërrimin dhe mallkimin. Ai (a.s), u lut që prej atij populli të dal një brez i cili do të adhuronte Allahun (xh.sh).

Shprehja e mëshirës së përgjithshme nga ana e besimtarit është nga tiparet e besimit të tij të plotë dhe të pranueshëm. Një herë Profeti (a.s) iu drejtua disa sahabëve me këto fjalë fisnike: “Nuk keni besuar për derisa nuk mëshironi njeri-tjetrin. Ata (sahabët) që ishin të pranishëm iu drejtuan Pejgamberit (a.s) duke i thënë: “O Resulull-llahu, të gjithë ne jemi të mëshirshëm me njëri-tjetrin”. Ai (a.s) u tha: “Mëshira duhet të jetë edhe me të tjerët në përgjithësi, pa përjashtim”. Për këtë çështje të rëndësishme shprehen edhe një sërë hadithesh profetike. Prej tyre mund të përmendim: “Ai i cili nuk mëshiron njerëzit nuk mëshirohet nga Allahu”, “Ai i cili nuk mëshiron atë që është në tokë nuk mëshirohet nga Ai që është në qiell”.

Me këto hadithe Profeti (a.s) na lajmëron se Zoti me Madhërinë e Tij i mëshiron ata që mëshirojnë të tjerët. Na porosit që të kemi mëshirë për të gjitha krijesat që janë në tokë, qofshin njerëz ose kafshë, që kështu të fitojmë mëshirën e Tij në qiell.

Jo vetëm kaq, por misioni Hyjnor i çdo profeti, veçanërisht të Muhammedit (a.s) ka qenë bazuar mbi parimin e mëshirës. Një ajet Kur'anor që lexohet vazhdimisht nga muezini përpara duasë (lutjes me xhemat) në çdo namaz shprehet kështu: “Ne, nuk të dërguam ty (Muhammed), vetëm se mëshirë për mbarë botët”. Pra, Muhammedi (a.s) nuk u dërgua si mëshirë vetëm për myslimanët, por për të gjitha krijesat. Për hir të tij edhe jobesimtarët shpëtuan prej ndëshkimeve siç u ndëshkuan popujt e mëparshëm.

Aq rëndësi i ka dhënë Islami çështjes së mëshirës sa që të gjitha suret e Kur'anit Famëllartë fillojnë me shprehjen Bismil-lahirr-rrahmanirr-rahim. Allahu (xh.sh) ka 99 emra si: Krijuesi, Furnizuesi, Duruesi, Udhëzuesi etj, por Madhnia e Tij absolute ka zgjedhur nga emrat e Tij Mëshirën për të na treguar vlerën e madhe që ka ajo në jetën tonë të përditshme. Edhe kur dikush ndërron jetë themi “pastë rahmet”, çka do të thotë pastë mëshirën e Allahut.

DISA LLOJE TË RËNDËSISHME TË MËSHIRËS:

1. Mëshirë me veten: Çka do të thotë që të mos dëmtojmë veten me gjëra që janë të dëmshme shpirtërisht dhe fizikisht. Allahu (xh.sh) për këtë thotë në Kur'an: “O ju të cilët keni besuar, mos e vritni veten tuaj, sepse Allahu ndaj jush është i Mëshirshëm”. Shprehja në këtë ajet “Mos e vritni veten tuaj” nuk ka kuptimin vetëm për vrasjen fizike, por do të thotë mos e dëmtoni atë shpirtërisht me haramet që ka ndaluar Krijuesi ynë i gjithësisë.

2. Të mëshirshëm me të afërmit tonë: Do të thotë që ne jemi të obliguar që t'i mbajmë fort lidhjet tona farefisnore dhe asnjëherë të mos i shkëpusim ato për kapriço dhe intriga të ndryshme njerëzore. Pejgamberi (a.s), na ka paralajmëruar për një gjë të tillë duke na thënë: “Nuk hyn në xhenet ai i cili i shkëput lidhjet farefisnore”.

3. Të mëshirshëm me fëmijët: Për këtë kemi shembullin konkret të të Dërguarit të Allahut (xh.sh) (Muhammedin (a.s) i cili ka qenë i mëshirshëm dhe shumë i sjellshëm me fëmijët dhe nipat e tij, Hasanin dhe Hysenin. Pikërisht për këtë lloj mëshire ka thënë: “Ai i cili nuk mëshiron fëmijët (në përgjithësi) dhe nuk nderon të mëdhenjtë nuk është prej nesh”.

4. Të mëshirshëm me të vobektit dhe jetimët: Do të thotë që ne duhet t'i gjendemi afër çdo lloj kategorie në nevojë. Një herë tregohet se një njeri erdhi te Pejgamberi (a.s) dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut, zemra ime është e ashpër dhe e egër, si mund ta bëj atë të butë dhe të mëshirshme?”. Pejgamberi (a.s) ju përgjigj duke i thënë: “Fërkoje kokën e jetimit dhe ushqe njerëzinë”. Shprehja “Fërkoje kokën e jetimit” nuk do të thotë që t'i thuash atij se të dua fort, por do të thotë që t'i gjendesh afër materialisht dhe shpirtërisht aq sa ke mundësi.

Si përfundim, le të rrënjësim në zemrat tona këtë veti madhështore islame, le të vijojmë mëshirën e Profetit tonë të dashur në të gjitha hapat e kësaj bote lëndore dhe le të mëshirojmë njeri-tjetrin në mënyrë që të fitojmë mëshirën e Allahut (xh.sh) si në këtë botë të përkohshme ashtu edhe në atë të amshuar. Amin!

Di tën e shtunë paradite, më 29 prill 2018, në ambientet e kompleksit “Zmijani”, Myftinia Shkodër organizoi aktivitetin e madh të Konkursit të 8-të vjetor me nxënësit e mejtepeve të kurseve fetare, që zhvillohen në xhamitë e Shkodrës.

Aktiviteti që mbledhi mbi 600 nxënës nga 34 xhami filloi me hapjen e drejtuesit të arsimit, teologut Arben Halluni, i cili pasi iu uroj mirëseardhjen nxënësve frekuentues sistematikë në mejtepet e xhamive u foli për rëndësinë që ka kjo ditë, e cila frymëzon për besim, adhurim, edukatë, kulturë, respekt, atdhedashuri, traditë, vëllazëri dhe harmoni me të gjithë.

Aktiviteti i konkursit të madh fetar u shoqërua me lojëra sportive dhe zbavitëse në ambientet e kompleksit.

Në fund u zhvillua ceremonia e shpalljes së fituesve, ku juria e përbërë nga teologët Lavdrim Hamja, Naim Drijaj dhe Adem Pizga vendosën në bazë të pikëve maksimale për çmimin e parë: Ersad Bregu, xhamia Barbullush, çmimi i dytë: Sulejman Milani, xhamia e Milan dhe çmimi i tretë: Matteo Çeliku, xhamia Golem.

Ndërsa çmimi për zërin e bukur në leximin e Kur'anit e mori nxënësi Muhamed Muça, xhamia Shtoj i Vjetër.

Gjithashtu u dhanë edhe 6 çmime (fletë lavdërimi) për nxënësit që kanë spikatur gjatë konkursit fetar dhe gjithashtu të dalluar në procesin mësimor të kursit fetar si: Vedat Kastrati, xhamia Baççallek, Senad Seferaj, xhamia Melgushë, Nevil Pepaj, xhamia Guci e Re, Emina Keçi, xhamia Luarëz, Mersila Zalli, xhamia Trush dhe Selma Fangaj, xhamia Bardhaj.

U ZHVILLUA KONKURSI I 8-TË ME NXËNËSIT E MEJTEPEVE TË XHAMIVE TË SHKODRËS



Pasditën e së hënës, më 7 maj 2018, nga xhamia “Ebu Bekër” nisi cikli i ligjëratave dhe këshillave fetare në prag të Muajit Ramazan 1439.

Në këtë aktivitet me vlerë u dhanë këshilla mbi vlerën e Ramazanit dhe rëndësinë e leximit, kuptimit dhe praktikimit të Kur'anit në jetë.

Aktiviteti filloi me fjalën e rastit nga teologu Arben Halluni, i cili theksoi se Muaji i Ramazanit është një periudhë e begatë e vitit, e shumëpritur nga muslimanët e mbarë botës.

Ndërkohë, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari dha mesazhin e tij duke tërhequr vëmendjen drejt shfrytëzimit të këtij muaji për të rregulluar marrëdhënien me Kur'anin Famëlartë dhe udhëzimet e tij dritësuese.

Imam i xhamisë së “Dy Vajzave”, teologu Lavdrim Hamja u ndal te rëndësia dhe vlera e Kur'anit në jetën e besimtarëve dhe nxitja që i bën i Dërguari i All-llahut angazhimit për mësimin dhe praktikimin e tij në jetë.

NISI CIKLI I LIGJËRATAVE FETARE NË PRAG TË RAMAZANIT 1439



Imami i xhamisë “Ebu Bekër”, teologu Gilmani Kazazi hodhi dritë mbi detaje të dobishme që lidhen me Ramazanin si muaj i moralit dhe përsosmërisë së tij

në shoqëritë njerëzore.

Në përfundim të kësaj mbledhjeje të paqte, u shpërnda edhe kalendari i Muajit të agjërit.

XHAMIA DUDAS DHE XHAMIA E “DY VAJZAVE”, LIGJËRATA NË PRAG TË RAMAZANIT 1439

Në vazhden e aktiviteteve që i paraprijnë Muajit Ramazan 1439, Myftinia Shkodër organizoi ditën e martë dhe të mërkurë, dy tubime të begata në xhaminë e Dudasit dhe tek ajo e “Dy Vajzave”.

Gjatë ligjëratave të mbajtura nga imamët dhe teologët e qytetit, u vu theksi tek vlerat e mëdha që ka Muaji Ramazan në afrimin e besimtarëve me All-llahun dhe udhëzimet e fesë, si dritësim për jetën e njerëzve.

U theksua se nëpërmjet agjërit, muslimanët e mbarë botës bashkohen në lutje dhe adhurime, që e ndihmojnë unitetin dhe frymëzojnë fuqizimin e ymetit islam.

Njëkohësisht, imamët tanë dhanë udhëzime për shfrytëzimin e Muajit Ramazan, si mundësi e pendimit, faljes, përmirësimit të marrëdhënies me Zotin, kthimit nga Kur'ani dhe mësimet e tij, përhapja e paqes dhe bamirësive në shoqëri, etj.

Në këto tubime të begata ligjëruan imamët e nderuar: Adrian Uraj, Arben Halluni, Idrir Plaku, Lavdrim Hamja, Durim Kasemi, Ervil Kuçi dhe Adil Cukali.

Në përfundim të aktivitetit në xhaminë e “Dy Vajzave” u shpërnda literaturë islame, falë bashkëpunimit me Institutin Shqiptar të Mendimit dhe Qytetërimit Islam.



MYFTIU VIZITOI KRYETARIN E SHOQATËS “ISTANBUL”



Myftiu për këtë vizitë, theksoi se ky bashkëpunim i frytshëm me Myftininë e Shkodrës do të vazhdojë, edhe në

shërbim të interesave të përbashkëta të Thirrjes Islame dhe gjallërimit të jetës fetare islame në vend.

Paraditën e së enjtes, më 10 maj 2018, në kuadër të vizitave të prag Ramazanit të sivjetshëm, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari zhvilloi një vizitë në zyrën e Kryetarit të Shoqatës “Istanbul”, z. Ridvan Seferaj.

Gjatë takimit, dy bashkëbiseduesit diskutuan rreth rrugëve të bashkëpunimit të mëtejshëm, sidomos në ditët e Muajit Ramazan, në shërbim të frymës së begatë të këtij muaji dhe angazhimeve të përbashkëta.

Nga ana e tij, Myfti falënderoi mikpritësin për kontributet e mëdha që Shoqata “Istanbul” jep në Shkodër, në disa drejtime, duke dëshmuar rritje të vazhdueshme në investimet e ndryshme, sidomos në arsim dhe bamirësi.

Ndërkohë, z. Seferaj, pasi falënderoi

Në vazhden e ligjëratave udhëzuese mbi vlerën e Muajit Ramazan 1439, Myftinia Shkodër vijoi ditën e enjte, më 10 maj 2018, me aktivitetin e radhës në xhaminë e lagjes Rus.

Të pranishmit i përshëndeti Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, sikurse ligjëruan edhe imamët e nderuar Altin Nikshiqi, Naim Drijaj dhe H. Fejzi Zaganjori.

Në bisedata e tyre, imamët e nderuar folën për vlerat e leximit të Kur'anit Famëlartë, çfarë na kujton muaji i Ramzanit dhe rreth këndvështrimit filozofik dhe social të agjërit të këtij muajit të begatë.

Exhumaja e datës 11 maj 2018 do të mbahet mend si një ngjarje historike për muslimanët e Shkodrës, në raport me rimëkëmbjen e vakëfeve të heshtura, mbi të cilat dikur ngriheshin xhami, që u shërbyen besimtarëve për dekada e shekuj, në rrugëtimin e tyre drejt fitimit të pëlqimit të All-llahut në jetën e kësaj bote.

Pikërisht ditën e sotme, pas një heshtjeje mbi 50 vjeçare, u këndua ezani i namazit të xhumasë mbi mbetjet e minares monumentale, mbi truallin vakëf të asaj që dikur ishte xhamia e Tabakut.

Medresisti Omer Fuqia me zërin e tij melodioz zgjoi emocione të mëdha dhe lot gëzimi tek besimtarët e pranishëm, kur lajmëroi hyrjen e kohës së mesditës me: “All-llahu ekber”, që mbuloi horizontet me bekim e mirësi.

Hytben e kësaj të xhumaje të parë pas shumë dekadash në këtë vend të shtrenjtë për muslimanët e Shkodrës, e mbajti Myftiu Imam Muhamed B. Sytari, i cili

NJË PASDITE E BEGATË NË OBORRIN E XHAMISË SË RUSIT



E XHUMAJA HISTORIKE TE VAKËFI I SHENJTË I TABAKUT



dha mesazhe të rëndësishme që përkojnë edhe me atmosferën e begatë të afrimit të Muajit Ramazan 1439.

Myftiu u lut për besimtarët dhe qytetarët e kësaj zone, për ata të Shkodrës, Shqipërisë dhe mbarë ymetit

islam kudo në botë dhe uroi agjërim të mbarë për të gjithë.

Falja e kësaj të xhumaje në këtë vend, shënoi edhe fillimin e një marrëdhënieje të re të Myftinisë Shkodër dhe muslimanëve të saj me këtë vakëf të nëpërkëmbur ndër vite.

Paraditën e të mërkurës, më 2 maj 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune me imamët teologë të qytetit të Shkodrës, me të cilët diskutoi rreth programit të larmishëm të Ramazanit të sivjetshëm.

U diskutua mbi projekt-idenë e zhvillimit të tribunave fetare në prag të fillimit të Ramazanit, duke ndjekur traditën e bukur të vitit që shkoj, ku u organizuan disa aktivitete të larmishme në oborret e xhamive të ndryshme të qytetit dhe fshatit.

U propozuan disa mënyra për shfrytëzimin e medias në favor të mesazheve të këtij Muajit, sikurse u vu theksi edhe te domosdoshmëria e shpërndarjes së botimeve të reja me këtë rast, përfshi kalendarin e agjërimit, përkthimin në shqip të Kur'anit Famëllartë, etj.

Njëkohësisht u dha udhëzim, që

MYFTIU TAKOI IMAMËT E QYTETIT MBI PROGRAMET E RAMAZANIT 1439



hytbeja e xhumasë së kësaj jave në të gjitha xhamitë e Shkodrës të jetë mbi rëndësinë dhe vlerat e Muajit Ramazan dhe përgatitjen për pritjen e tij.

XHAMITË E SHKODRËS, HYTBEJA E XHUMASË NË PRAG TË RAMAZANIT

Sipas udhëzimit të Myftiut të Shkodrës, e xhumaja e datës 4 maj 2018 u fokusua te përgatitja e besimtarëve për pritjen e Muajit Ramazan.

Në të gjitha xhamitë e qytetit u mbajtën ligjërata rreth kësaj teme, duke nxitur besimtarët dhe mbarë opinionin drejt paqimit me Zotin dhe kthimin nga dyert e udhëzimit.

Nga minberi i xhamisë së Plumbit, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, tha se përgatitja më e mirë për pritjen e Ramazanit është pastrimi i zemrës dhe pajtimi në familje e shoqëri.



Ai tha se, zemra e qetë dhe e pastër nga zilia, smira, xhelozia, urrejtja e paragjykimi, është zemra e paqte për të cilën ka nevojë shoqëria e jonë, për ta përjetuar

si duhet Ramazanin dhe për ta kthyer atë në sistem jete.

Myftiu lajmëroi besimtarët edhe për programin e prag Ramazanit të sivjetshëm, sikurse lajmëroi se të xhumanë e ardhshme, më 11 maj 2018, e xhumaja do të falet për herë të parë pas shumë dekadash në vakëfin e shenjtë të Tabakut, bri xhamisë së Plumbit.

TAKIM PUNE ME MUEZINËT E QYTETIT



Paraditën e së hënës, më 7 maj 2018, në prag të Muajit Ramazan, Myftinia Shkodër zhvilloi një takim pune me muezinë dhe kujdestarë të xhamive të qytetit.

Me këtë rast, teologu Arben Halluni, u ndal tek disa çështje që lidhen me shërbimet e muezinë në xhami dhe rolin e tij mbarëvajtjen e aktivitetit fetar.

U vu theksi tek rëndësia e respektimit të orarit zyrtar të lajmërimit të hyrjes së kohës së namazit nëpërmjet ezanit, bashkëpunimi me imamin dhe këshillin e xhamisë për mbarëvajtjen e punës në xhami, etj.

Mbrëmjen e së xhumasë, më 11 maj 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ishte i ftuar në studion e Tv1 Channel për të folur mbi atmosferën dhe vlerat e Muajit Ramazan.

Myftiu tha se agjërimi i Muajit të begatë është një mundësi e madhe për të jetuar me besimin dhe përkushtimin në jetën e lirë, në marrëdhënien e përditshme me njerëzit, duke u përpjekur maksimalisht për të ruajtur ekuilibrat e besimit dhe dritën e tij.

Ai tha se Muaji Ramazan i ngjan një miku të madh që po vjen si dhuratë begatuese nga ana e Krijuesit të gjithësisë, "që do të thotë se besimtari është i ftuar për t'u përgatitur për Muajin e Madhnueshën të Ramazanit. Siç pastron shtëpinë me pastru zemrën, siç pastron orënditë me pastru gjuhën, siç pastron objektet e ndryshme me pastru shikimin, dëgjimin, moralin, sjelljen, korrektësinë në marrëdhënie me detajet kryesore të besimit. Mënyra më e mirë për ta pritur Ramazanin është me u pendu para duarve të Zotit ..."

MYFTIU FLET PËR ATMOSFERËN E RAMAZANIT DHE VLERAT E TIJ



Myftiu foli edhe për atmosferën e begatë të këtij Muaji në Shkodër, ku përmendi përgatitjet që po bën Myftinia Shkodër për ta afruar shpirtin e këtij Muaji me besimtarët dhe qytetarët, në mënyrë që hyrja e Hënës së re të Ramazanit 1439 t'i gjejë njerëzit te gatshëm e të përmalluar.

Myftiu i bëri thirrje dhe ftesë tregtarëve, biznesmenëve që ta shfrytëzojnë Muajin Ramazan për të dëshmuar solidaritetin me njerëzit në nevojë, duke ulur çmimet, duke falur borxhet, duke ndihmuar e duke përhapur shpresë dhe mirësi në shoqëri.

XHAMIA E PERASHIT, KËSHILLA TË DOBISHME NË PRAG TË RAMAZANIT

Pasditën e së xhumasë, më 11 maj 2018, në oborrin e xhamisë së Perashit u organizua një aktivitet fetar, me këshilla dhe udhëzime të dobishme që i vlejnë besimtarëve në prag të Muajit Ramazan 1439.

Në emër të organizatorit, teologu Ervil Kuçi vuri theksin te rëndësia që kanë tubimet e tilla, që mbledhin besimtarët që duan të përftojnë dhe që kanë mundësinë të hyjnë në atmosferën e Ramazanit, muajit të madh të mëshirës dhe faljes.

Aktivitetin e përshëndeti Myftiu i

Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili nxit të pranishmit për ta falënderuar Zotin e gjithësisë për udhëzimin në Islam, ku njeriu nuk e humbet asnjëherë shpresën dhe gjen përherë një prag ku të mbështetet, edhe në çastet më të vështira të jetës.

Më pas ligjëroi Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, i cili dha disa këshilla të dobishme në kuadër të shfrytëzimit të Muajit Ramazan, duke u përgatitur me pendim dhe lutje për pritjen e tij.

Myftiu i nderuar tha se Ramazani është

miku më i shtrenjtë që viziton besimtarët në hapësirat e një viti kalendarik, prandaj është e udhës që ta presim si duhet këtë mysafir që vjen me mirësi dhe bekime nga All-llahu i Madhëruar.

Ligjëruan edhe imamët e nderuar, Adem Pizga dhe Ruzhdi Plangaj, të cilët dhanë udhëzime dhe këshilla të dobishme për shfrytëzimin e kohës në Ramazan, për kontrollimin e namazeve ditore, leximin e rregullt dhe të plotë të Kur'anit dhe shtimin e bamirësive, që na afrojnë përherë e më shumë me shpirtin e besimit dhe fesë islame.

MBYLLET CIKLI I LIGJËRATAVE NË PRAG TË RAMAZANIT 1439



Ramazani është mundësi e madhe për të perfeksionuar lutjen, sidomos në ato kohë, kur ajo pranohet nga All-llahu i Madhëruar.

Në përfundim të këtij cikli të begatë ligjëratash, që u zhvilluan në xhamitë: "Ebu Bekër", Dudas, xhamia e "Dy Vajzave", Rus, Perash, Parrucë dhe xhamia e Medresesë, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari falënderoi imamët ligjëruar, pjesëmarrësit dhe krejt ata që u angazhuan për mbarëvajtjen e këtij karvani vlerash. Njëkohësisht uroi agjërim të lehtë dhe të pranuar.



1 RAMAZAN	SYFYRI 3:23 IFTARI 20:01	16 MAJ
2 RAMAZAN	SYFYRI 3:22 IFTARI 20:02	17 MAJ
3 RAMAZAN	SYFYRI 3:20 IFTARI 20:03	18 MAJ
4 RAMAZAN	SYFYRI 3:19 IFTARI 20:04	19 MAJ
5 RAMAZAN	SYFYRI 3:18 IFTARI 20:05	20 MAJ
6 RAMAZAN	SYFYRI 3:16 IFTARI 20:06	21 MAJ
7 RAMAZAN	SYFYRI 3:15 IFTARI 20:07	22 MAJ
8 RAMAZAN	SYFYRI 3:13 IFTARI 20:08	23 MAJ
9 RAMAZAN	SYFYRI 3:12 IFTARI 20:09	24 MAJ
10 RAMAZAN	SYFYRI 3:11 IFTARI 20:10	25 MAJ

11 RAMAZAN	SYFYRI 3:10 IFTARI 20:11	26 MAJ
12 RAMAZAN	SYFYRI 3:08 IFTARI 20:12	27 MAJ
13 RAMAZAN	SYFYRI 3:07 IFTARI 20:13	28 MAJ
14 RAMAZAN	SYFYRI 3:06 IFTARI 20:13	29 MAJ
15 RAMAZAN	SYFYRI 3:05 IFTARI 20:14	30 MAJ
16 RAMAZAN	SYFYRI 3:04 IFTARI 20:15	31 MAJ
17 RAMAZAN	SYFYRI 3:03 IFTARI 20:16	01 QERSHOR
18 RAMAZAN	SYFYRI 3:02 IFTARI 20:16	02 QERSHOR
19 RAMAZAN	SYFYRI 3:01 IFTARI 20:17	03 QERSHOR
20 RAMAZAN	SYFYRI 3:00 IFTARI 20:18	04 QERSHOR

21 RAMAZAN	SYFYRI 3:00 IFTARI 20:19	05 QERSHOR
22 RAMAZAN	SYFYRI 2:59 IFTARI 20:19	06 QERSHOR
23 RAMAZAN	SYFYRI 2:58 IFTARI 20:20	07 QERSHOR
24 RAMAZAN	SYFYRI 2:58 IFTARI 20:21	08 QERSHOR
25 RAMAZAN	SYFYRI 2:57 IFTARI 20:21	09 QERSHOR
26 RAMAZAN	SYFYRI 2:57 IFTARI 20:22	10 QERSHOR
27 RAMAZAN	SYFYRI 2:56 IFTARI 20:22	11 QERSHOR
28 RAMAZAN	SYFYRI 2:56 IFTARI 20:23	12 QERSHOR
29 RAMAZAN	SYFYRI 2:55 IFTARI 20:23	13 QERSHOR
30 RAMAZAN	SYFYRI 2:55 IFTARI 20:24	14 QERSHOR

FALJA E SABAHUT NË XHAMI BËHET 30 MINUTA PAS IMSAKUT (SYFYRIT)
ORARET I JANË REFERUAR ZONËS SË SHKODRËS

10 QERSHOR 2018 (E DIËL) - NATA E KADRIT

15 QERSHOR 2018, E XHUMA - DITA E PARË E FITËR BAJRAMIT - NAMAZI I BAJRAMIT FALET NË ORËN 06:00

RAMAZANI, MUAJI I BEGATISË

Sahabiu Ubade (r.a) transmeton se i Dërguari i All-llahut (a.s) ka thënë: "Ju erdhi Ramazani, muaji i begatisë. Ju mëshiron All-llahu në të, duke ju fshirë me mëshirën e Tij gabimet dhe duke iu përgjigjur lutjeve tuaja. Allllahu shikon në adhurimin tuaj dhe mburret me ju para mele-këve. Tregoni pra, All-llahut, nga vetja juaj vetëm të mira. I shkretë është vetëm ai, që s'e meriton mëshirën e All-llahut në këtë muaj!"

- Transmetuar nga Tabaraniu -

SADAKATUL - FITRI

Sadakaja e Fitrit është obligim për çdo mysliman, të madh e të vogël, plak e plakë, të ri e të re. Ibn Abbasi (r.a), transmeton se: "Profeti (a.s) e bëri detyrim zekatin (sadekanë) e fitrit, pastrim për agjëruesin, nga thashethemet dhe fjalët kote, si dhe ushqim për të varfrit. Kush e jep para namazit të Bajramit, ajo është zekat (sadaka) e pranuar e kush e jep pas tij, atëherë ajo është lëmoshë e zakonshme!" - (Ebu Davudi)

Është e pëlqyeshme që Sadekatul - Fitri të jepet 2-3 ditë, ose më shumë përpara faljes së namazit të Fitër Bajramit.

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org